

**Përgatiti dhe i përzgjedhi:**

Abdul Fetah Xhemilë Berri

**Titulli:**

FJALË TË ARTA TË MË TË MIRIT TË NJERËZIMIT,  
MUHAMEDIT A.S

**Lektura:**

Daut Shehu

**Botues:**

Përkthyesi

**Shtypi:**

FokusPrint, 2013

*Të drejtën e ribotimit e rezervon përkthyesi*



**Abdul Fetah Xhemilë Berri**

**FJALË TË ARTA TË MË TË MIRIT TË  
NJERËZIMIT, MUHAMEDIT A.S.**

**Përktheu: Dr. Musli Vërbani**  
Kaçanik, 2013

### **Hadithi - 1:**

*Transmetohet nga Omer bin el Hatabi se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit dhe çdokush shpërblehet ashtu si e ka pasur qëllimin.

Kush ka migruar për Allahun dhe të dërguarin e tij shpërblehet, sepse ka migruar për Allahun dhe të dërguarin e tij.

Kush ka migruar për interes të kësaj bote, apo për t'u martuar me ndonjë grua, ai do të shpërblehet për atë qëllim migrimi.

DY SHEJHAT |

### **Hadithi - 2:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Unë jam me robin tim dhe me mendimin e robit tim. Nëse më përkujton në vete, e përkujtoj edhe më mirë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 3:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtet Zoti i ka 99 emra: kush i numëron, i llogarit, do të hyjë në xhenet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 4:**

*Transmetohet nga Ibdetu bin Samed r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush dëshiron takim me Zotin, Zoti dëshiron takim me të.

Kush e urren takimin me Zotin, Zoti e urren takimin me të.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 5:**

Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:  
Kush thotë SUBHANELLAH VE BI HAMDIHI 100 herë në ditë, i fshihen gabimet, qofshin sa shkuma e detit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 6:**

Transmetohet nga Enes r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:  
Prej lutjeve të shpeshta të të Dërguarit ka qenë:  
O Zoti ynë, na jep prej të mirave në këtë botë e në botën tjetër dhe na shpëto prej zjarrit të xhehenemit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 7:**

Transmetohet nga Ejubi Ensariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:  
Kush thotë 10 herë LA ILAHE IL-LALL-LLAU VAHDEHU LA SHERIKE LEH LEHUL MULKU VE LEHUL HAMDU VE HUVE ALA KULI SHEJIN KADIJR

– ka shpërblim sikur të kishte liruuar një rob nga bijtë e Ismailit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 8:**

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:  
Dy fjali për gjuhën janë të lehta, por peshojnë rëndë në peshojë, dhe janë të dashura për të Mëshirshmin:  
SUBHANALLAHI VE BIHAMDIHI,  
SUBHANALLAHIL ADHIJM.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 9:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. thoshte:*

O Zoti im!

Kërkoj mbrojtje nga: paaftësia, përtacia, koprracia, kryelartësia;

Kërkoj mbrojtje nga dënimi në varr.

Kërkoj mbrojtje nga sprova e jetës dhe e vdekjes.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 10:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se:*

I Dërguari i All-llahut kërkonte mbrojtje te All-llahu:

- nga lodhja e sprovave,

- nga padëgjueshmëria,

- nga përfundimi i keq dhe

- nga të këqijat e armiqve.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 11:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ta dëgjoni zërin e gjelit, lutjuni All-llahut për të mirat e Tij, sepse gjeli e ka parë melekun, ndërsa:

Kur ta dëgjoni zërin e gomarit, kërkoni mbrojtje nga shejtani i mallkuar, sepse ai e ka parë shejtanin.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 12:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se i Dërguari i All-llahut (s.a.v.s) ka thënë:*

I pranohet lutja ndonjërit prej juve, edhe nëse i vonohet, edhe pse ai me gurrin thotë Jam lutur, por nuk më është pranuar.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 13:**

*Transmetohet nga Ebu Bekri Sidiki r.a. se:*

I ka thënë Muhamedit a.s.: Më mëso çka të them pas çdo namazi.

Muhamedi a.s i ka thënë:

Thuaj: O Zoti im, i kam bërë vetes padrejtësi të shumta. Përveç Teje askush nuk i fal gabimet. Më fal me Mëshirën Tënde. Vërtet Ti je Falës, Mëshirues.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 14:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se:*

Muhamedi a.s. kur shihte fatkeqësi thoshte:

LA ILAHE IL-LALLAHUL ADHIJMUL HALIJM. RABUL ARSHIL ADHIJM. RABUS-SEMAVATI VEL ERDI VE RABBUL ARSHIL KERIMË.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 15:**

*Transmetohet nga Usamete bin Zejd r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Pas meje nuk kam lënë sprovë më të vështirë për burrat se sa sprova e grave.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 16:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

All-llahu xh.sh. e ka ndarë mëshirën e Tij në 100 pjesë, 99 pjesë i ka mbajtur dhe një pjesë e ka lëshuar në tokë; nga ajo pjesë mëshirohen krijesat, aq sa edhe kali e heq këmbën nga mëzi, nga frika se mos po e shkel.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 17:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se njëri e ka pyetur Muhamedin a.s.:*

Si do të ishte sikur t'i falsha namazet farze, të agjëroja Ramazanin, të punoja çka është e lejuar dhe të largohesha nga ajo çka është e ndaluar, a do të hyja në xhenet?.

Po! I është përgjigjur i Dërguari.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 18:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çka ju kam ndaluar, largohuni, çka ju kam urdhëruar, veproni. Sepse popujt para jush janë shkatërruar nga pyetjet e shumta të tyre dhe kundërshtimi i tyre ndaj të Dërguarve.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 19:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos u hidhëro, mos u hidhëro, këtë e ka përsëritur disa herë.

BUHARIU |

### **Hadithi - 20:**

*Transmetohet nga Temijm Dari r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Feja është këshillë. E pyetëm: Për kë, o i Dërguar i Zotit?

Është përgjigjur: Për All-llahun, për librin e tij, për të Dërguarin Tij.

MUSLIMI |

**Hadithi - 21:**

*Transmetohet nga Ebu Dardai r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Është e pamundur që muslimani të lutet për vëllain e tij e të mos thotë Melaqja: Edhe ty po ashtu.

MUSLIMI |

**Hadithi - 22:**

*Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:*

Mos u përbetoni në LATIN dhe UZAN për thuani:

LA ILAHE IL-LALLAH.

Në vend se t'i thuhet shokut: Eja të luajmë së bashku bixhoz, le t'i thuhet: Eja të japim sadaka.

RUVIJE FI SAHIHAJNI |

**Hadithi - 23:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mjafton për njeriun rrena, për të thënë gjithë atë çka e dëgjon.

MUSLIMI |

**Hadithi - 24:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sharja e muslimanit është fisk (mëkat i madh). Vrasja e muslimanit është kufr (pabesim).

SAHIHAJNI |



### **Hadithi - 25:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Umer bin Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Prej gabimeve të mëdha është sharja e prindërve të Tij.

E kanë pyetur të Dërguarin: A është e mundur që njeriu t'i shajë prindërit e tij?!

U është përgjigjur: Po! Ia shanë njeriu babain tjetrit, e ai ia shanë babain dhe nënën.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 26:**

*Transmeton Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur njeriu i thotë vëllait të tij O pabesimtar, ndërsa veç e njohin njëri-tjetrin, nëse është ashtu, në rregull, nëse nuk është ashtu (pabesimtar) siç i thotë, i kthehet fjala atij i cili i ka thënë.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 27:**

*Transmetohet nga Dehak r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mallkimi i besimtarit është sikur vrasja e tij.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 28:**

*Transmetohet nga Ebu Dherri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Tre personave nuk do t'u flasë All-llahu në ditën e gjykimit, as nuk do t'i shikojë, as nuk do t'i pastrojë, por do t'i dënojë dhimbshëm. Këtë e ka përsëritur tri herë, e ka vazhduar duke thënë: ata kanë dështuar dhe kanë humbur, deri sa Ebu Dherri r.a.i ka thënë: Po cilët janë o i Dërguar i All-llahut?

E Muhamedi a.s. është përgjigjur: Ai i cili i lëshon mëngët me kryelartësi, përgojuesi, dhe ai i cili e shet mallin me përбетim të rrejshëm.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 29:**

*Transmetohet nga Ebi Bekrete Nefrë bin Harith r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A dëshironi t'ju tregoj për gabimet e mëdha (këtë e ka përsëritur tri herë).

Thamë: Po, o i Dërguari i All-llahut?

Tha:

- T'i bësh shok All-llahut.

- Të sillesh ashpër me prindërit.

Ishte mbështetur e ulur dhe tha:

- Shpifja.

- Dëshmia e rrejshme. Vazhdimisht e thoshte, deri sa menduam se nuk do të ndalet.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 30:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush ka në zemrën e tij kryelartësi sa grimca e atomit, nuk do të hyjë në xhenet.

Një njeri e pyeti: Në të vërtetë njeriu dëshiron që rroba e tij të jetë e bukur dhe veshmbathja e tij të jetë e bukur?

(Muhamedi a.s.) Tha: Zoti është i bukur, e do të bukurën. Kryelartësia është: të fshehurit e së vërtetës dhe të nënçmuarit e njerëzve.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 31:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Dy gjëra njeriun e shpiejnë në pabesim:

-Vajtimi për të vdekurin, dhe

- t'i mohosh njeriut gjakun (prejardhjen e tij).

MUSLIMI |

**Hadithi - 32:**

*Transmetohet nga Sehl bin Sead r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush më garanton mua për atë çfarë ka në mes të mjekrës dhe këmbëve, unë i garantoj xhenetin.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 33:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi Hudrij r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush prej jush e sheh një të keqe, le ta largojë me dorën e tij,  
por nëse nuk ka mundësi, me gjuhën e tij,  
por nëse nuk ka mundësi, me zemrën e tij, e kjo është dobësia e Imanit.

MUSLIMI |

**Hadithi - 34:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Për çdo pjesë dhe gjymtyrë të njeriut ka sadaka,  
- Për çdo ditë në të cilën lind dielli ku bëhet pajtimi në mes të dy personave është sadaka.  
- T'i ndihmosh njeriut për të hipur në kafshën e tij është sadaka.  
- T'i ndihmosh të mbajë barrën është sadaka.  
- Fjala e mirë është sadaka.  
- Për çdo hap të cilën e bën ai i cili shkon të falet, është sadaka.  
- Të larguarit e mbeturinave nga rrugë është sadaka.

SAHIHAJN |

**Hadithi - 35:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mësyshi është i vërtetë, nëse diçka do të kishte parakaluar kaderin, do të ishte syri. Kur të pastroheni, pastrohuni plotësisht.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 36:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk është trimëri në përleshje, por trimëri e vërtetë është të sunduarit e vetvetes në rast hidhërimi.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 37:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush thotë para marrëdhënies me gruan:

Në emër të All-llahut, O Zoti Im! Largoje shejtanin nga ne, dhe nga pasardhësi i formuar (prej kësaj nate) dhe iu dhurohet fëmijë, shejtani nuk mund ta dëmtojë atë fëmijë.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 38:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Të drejtat dhe obligimet e muslimanit ndaj muslimanit janë pesë:

- t'i përgjigjesh në selam,
- të vizitosh të sëmurin,
- të përcjellësh kufomën,
- t'i përgjigjesh në ftesë, dhe
- t'i thuash të mëshiroftë Zoti kur të teshtijë.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 39:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se në prani të Muhamedit a.s. kanë teshtirë dy njerëz:*

të parit Muhamedi a.s. i thotë JERHAMUKEALLAH (Zoti të mëshiroftë), ndërsa tjetrit jo. Pastaj, ai, të cilit Muhamedi a.s. nuk i ka thënë JERHAMUKEALLAH, i tha Muhamedit a.s.: Filani teshtiu, e përshëndete, ndërsa unë teshtiva, nuk më përshëndete, Muhamedi a.s. iu përgjigj: Ai e falënderoi All-llahun e Lartmadhëruar, ndërsa ti nuk e falënderove All-llahun e Lartmadhëruar.

SAHIHAJN |

Hadithi - 40:

*Transmetohet nga Ebi Musa Eshariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kërko leje tri herë, nëse të lejohet hyr, e nëse jo kthehu.

SAHIHAJNI |

**Hadithi - 41:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

- Kalorësi përshëndet këmbësin.
- Këmbësin të ulurin.
- Grupi i vogël grupin e madh.

SAHIHAJNI |

**Hadithi - 42:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti i madhëruar është i kënaqur me robin, i cili kur ha, falënderon (Zotin) Atë, kur pi ujë, e falënderon Atë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 43:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

I Dërguari i Zotit kurrë nuk e ka përbuzur (nënçmuar) ushqimin, nëse ka qenë i shijshëm e ka ngrënë, e nëse nuk i ka pëlqyer nuk e ka ngrënë.

SAHIHAJNI |

**Hadithi - 44:**

*Transmetohet nga Umer bin Selmete r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Përkujtoje Zotin, ha me të djathtën, dhe ha nga ajo çka të takon.

SAHIHAJNI |

#### **Hadithi - 45:**

*Transmetohet nga Sahl Ibn Hanijë r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush kërkon dëshmorinë me zemër të plotë dhe gjuhë të pastër, Zoti do ta ngritë në shkallën e dëshmorëve, edhe nëse vdes në shtrat.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 46:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në mes të varrit tim dhe Minberit tim është një bashqë prej bashqeve të xhenetit.

SAHIHAJNI |

#### **Hadithi - 47:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. e ka përmendur ditën e xhumasë dhe ka thënë:*

Në të është një çast në të cilin, nëse lutet robi i All-llahut, do t'ia pranojë lutjen dhe do t'i përgjigjet.

SAHIHAJNI |

#### **Hadithi - 48:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se e ka pyetur Muhamedin a.s.:*

Çka të them, o i Dërguari i Zotit? (duke pasur për qëllim rastin e vizitës së varreve).

Thuaj: Shpëtimi dhe paqja qoftë mbi ju, o shtëpi e besimtarëve dhe e muslimanëve, Zoti ju mëshiroftë juve, o banues të tashëm dhe të ardhshëm dhe, me dëshirën e Zotit, edhe ne do të vijmë pas jush.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 49:**

*Transmetohet nga Umeri r.a. se:*

Sead bin Ibadete e vizitoi të Dërguarin e Zotit së bashku me Abdurr Rrahman bin Aufin, Sead bin Vekasin dhe Abdullah bin Mes'udin, dhe i Dërguari i Zotit filloi të qajë. Kur e panë të tjerët, filluan të qajnë, atëherë Muhamedi a.s. tha: A nuk e dini se Zoti nuk dënon për shkak të gjakut të syve, as për shkak të pikëllimit të zemrës, por dënon apo mëshiron për shkak të kësaj, duke sinjalizuar në gjuhën e tij.

SAHIHAJNI |

#### **Hadithi - 50:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

Robin tim aq shumë e shpërblej sa që e sjell në gjendje të ndahet nga kjo botë i pastër si loti, duke duruar edhe për vështërsinë e dhënies së frymës së fundit, që pastaj të fitojë xhenetin.

BUHARIU |

#### **Hadithi - 51:**

*Transmetohet nga Umi Seleme r.a. se Muhamedit a.s. i ka thënë:*

Robi i cili në rast fatkeqësie thotë: Ne jemi të Zotit dhe ne te Ai do të kthehemi; O Zoti im më shpërble (më kompenso) këtë fatkeqësi, dhe më zëvendëso me të mirë, Zoti atë fatkeqësi do t'ia shndërrojë në të mirë.

(Umi Seleme) Tha: Kur vdiq Ebu Selmete, u luta ashtu siç më kishte urdhëruar i Dërguari i Zotit, dhe Zoti më zëvendësoi me më të mirë – Muhamedin a.s..

MUSLIMI |

### **Hadithi - 52:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi Hudri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Të sëmurit në shtrat të vdekjes përkujtojani dëshminë: LA ILAHE IL-LALL-LLAH.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 53:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Askush prej jush mos ta dëshirojë vdekjen për shkak të vështirësisë në jetë, por nëse patjetër duhet thënë, le të thotë: O Zoti im! Më lër të jetojë, nëse jeta është për të mirën time. Më bëj të vdes, nëse vdekja është për të mirën time.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 54:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Do t'ju vijë shejtani dhe do t'ju pyetë:

- Kush e ka krijuar këtë?

- Kush e ka krijuar këtë?

- Derisa do të pyetë kush e ka krijuar Zotin tënd?

- Kur të arrijë në këtë shkallë, le të kërkojë çdonjëri prej jush mbështetje te Zoti nga Shejtani i mallkuar dhe le ta mallkojë atë.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 55:**

*Transmetohet nga Ebi Musa Eshariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur'anin këndojeni me vëmendje dhe përmbajuni rregullave të tij se betohem në Atë i cili ka shpirtin e Muhamedit në dorën e tij, ky Kur'an nuk ndahet prej juve, ashtu sikurse deveja, e cila nuk ndahet nga litari i lidhur.

SAHIHAJNI |



### **Hadithi - 56:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Vërtetë gjatë natës është një moment në të cilin, nëse përputhet lutja e muslimanit në atë moment duke kërkuar të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, Zoti do t'i japë atij atë që kërkon.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 57:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti ynë i Lartësuar dhe i Lavdëruar për çdo mbrëmje zbret në qiellin e kësaj bote dhe deri në pjesën e tretë të natës thotë: - Kush më lutet, i përgjigjem:

- Kush më kërkon, i jap dhe
- kush kërkon falje, i fal gabimin.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 58:**

*Transmetohet nga Said Hudri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nëse ndonjëri prej jush ëndërron ëndërr të mirë (çfarë e dëshiron), ajo është prej Zotit, le ta falënderojë (Atë) All-llahun e Madhëruar për atë ëndërr dhe le ta tregojë.

BUHARIU |

### **Hadithi - 59:**

*Transmetohet nga Berra bin Azib r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të shkosh për të fjetur: merr abdest, pastaj shtrihu në krahun e djathtë dhe thuaj:

O Zoti im!

- E nënshtrova trupin tim tek Ti

- Çështjet e mia i lashë tek Ti dhe

- e mbështeta shpinën time tek Ti, me frikë e shpresë se nuk ka mbrojtje dhe mbështetje përpos tek Ti,

- besova në librin Tënd të cilin ia ke zbritur të Dërguarit Tënd, nëse ma merr shpirtin, merre me shehadet dhe në fenë e vërtetë.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 60:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se:*

Një ditë i vjen një njeri Muhamedit a.s. dhe e lajmëron se e ka kafshuar akrepi. E Muhamedi a.s. i ka thënë:

Po të kishe thënë kur ke rënë për të fjetur: Kërkoj mbrojtje nga fjalët e vërteta, të cilat Zoti i Madhëruar i ka thënë, dhe nga çdo e keqe, e cila është krijuar, nuk do të të dëmtonte asgjë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 61:**

*Transmetohet nga Thubani r.a. se Muhamedi a.s.:*

Kur (largohej) përfundonte namazin kërkonte falje tri herë, pastaj thoshte:

ALLAHUME ENTE SELAM VE MINKE SELAM TEBAREKTE  
JA DHEL XHELALI VEL IKRAM.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 62:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ta përfundojë ndokush namazin, le të kërkojë mbështetje prej Zotit të Madhëruar për katër sende:

- prej dënimit të xhehenemit,
- prej dënimit në varr,
- prej sprovimeve të jetës dhe vdekjes, si dhe
- prej të keqes së Dexhallit.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 63:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. në sexhde thoshte:*

O Zoti im! Fali gabimet e mia, qofshin të vogla apo të mëdha, të parën apo të fundit, atë çka e di, apo nuk e di.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 64:**

*Transmetohet nga Aliu r.a. se Muhamedi a.s. kur binte në sexhde thoshte:*

O Zoti im, për Ty e vura ballin tim në sexhde. Ty të besoj dhe Ty të dorëzohem. E vura ballin në sexhde për Atë i cili e ka krijuar, e ka formuar, më ka dhënë shikimin e dëgjimin. Lavdi i qoftë All-llahut. Ai është krijuesi më i miri.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 65:**

*Transmetohet nga Rufaatu bin Rafië Zurkiji r.a. se ka thënë:*

Një ditë, deri sa ishim duke u falur pas Muhamedit a.s., kur ai e ngriti kokën nga rukuja dhe tha:

SEMI ALL-LLAHU LIMEN HAMIDEH një xhemat pas tij tha:

RABENA VE LEKEL HAMD HAMDEN KETHIREN TAJIBEN MUBAREKEN FIJHI.

Kur përfundoi namazi, Muhamedi a.s. tha: Kush ishte ai i cili i vazhdoi fjalët pas meje. U paraqit xhemati në fjalë, ndërsa Muhamedi a.s. tha: I kam parë tridhjetë e disa Melek duke shpejtuar se cila prej tyre do ta shkruajë sa më parë.

BUHARIU |

### **Hadithi - 66:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. gjatë rukusë së tij dhe sexhdes së tij thoshte:*

SUBUHU KUDUSU RABUL MELAIKETU VE RRUHU.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 67:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. thoshte në sexhde:*

SUBHANEKE LLAHUME RABI-BINA VE BI HAMDIKE ALL-LLAHUMEGFIRLIJ.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 68:**

*Transmetohët nga Xhabiri r.a se Muhamedi a.s ka thënë:*

Çdo herë kur të luteni për veten tuaj, ose për familjen tuaj, ose për pasurinë tuaj dhe është në kohën apo momentin kur i pranon Zoti lutjet, Zoti përgjigjet dhe i jep lutësit atë që kërkon.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 69:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Tre persona nuk i shikon Zoti dhe as nuk u flet, por i dënon dhimbshëm:

- Plakun prostitut,
- udhëheqësin rrenacak dhe
- të varfrin kryelart.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 70:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Robi më së afërti tek Zoti është deri sa ai është në sexhde, pra shtoni lutjet.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 71:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush thotë prej kohës së agimit të ditës e deri kur të errësohet SUBHANELLAHI VE BI HAMDIHI 100 herë, në ditën e gjykimit nuk do të vijë asnjëri sikur ai.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 72:**

*Transmetohet nga Ebi Musa Eshariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shembulli i atij i cili e përkujton Zotin dhe të atij i cili nuk e përkujton Zotin, i përngjan shembullit të të gjallit dhe të vdekurit.

BUHARIU |

### **Hadithi - 73:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr Ibn As r.a se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të dëgjoni Muezinin përsëritni fjalët të cilat i thotë ai, pastaj dërgoni salavat për mua, sepse kush dërgon salavat për mua Zoti do t'ia dhjetëfishojë; pastaj kërkoni prej Zotit ndërmjetësim, sepse ndërmjetësimi im është një vend në xhenet në të cilin nuk do të hyjnë vetëm robërit e Zotit, por do të jem edhe unë dhe kush kërkon prej Zotit që unë të ndërmjetësoj për të, Unë padyshim se do të ndërmjetësoj.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 74:**

*Transmetohet nga Ebi Hudriji r.a. se ka treguar:*

E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë:

Zërin e muezinit pa marrë parasysh a e dëgjon xhin, njeri apo diçka tjetër do të dëshmojë për atë dëgjim të ezanit në ditën e kijametit.

BUHARIU |

### **Hadithi - 75:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. para se të hynte në nevojtores thoshte:*

O Zoti im! Unë te Ti kërkoj mbështetje nga fëlliqësira dhe të këqijat.

SAHIHAJNI |

### **Hadithi - 76:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se:*

Muhamedit a.s. i pëlqente të fillojë nga e djathta në çdo punë:

- në pastrim,
- në veshjen e rrobave dhe
- në veshjen e mbathjeve (këpucëve).

SHEJHANI |

### **Hadithi - 77:**

*Transmetohet nga Xhabir Ibn Abdullah se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur njeriu hyn në shtëpi dhe e përkujton Zotin në hyrjen e tij dhe kur ai ushqehet, shejtani thotë: Këtu nuk ka vendstrehim dhe as ushqim. Nëse hyn dhe nuk e përkujton Zotin, shejtani thotë: E siguruam vendstrehimin. Nëse ushqehet dhe nuk e përkujton Zotin, shejtani thotë: E siguruam edhe ushqimin edhe vendqëndrimin.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 78:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. thoshte:*

O Zoti im!

- Përforcoma fenë time, e cila është mbrojtje e të gjitha çështjeve të mia, përforcoje botën time, e cila është bazë e jetës sime.
- Më ndihmo të fitoj botën tjetër, e cila është vendkthimi im aty.
- Bëje jetën time të mirë në çdo çështje.
- Bëje vdekjen time të qetë dhe të siguruar nga çdo e keqe.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 79:**

*Transmetohet nga Ebi Vekasi se Muhamedi a.s ka thënë:*

A po neglizhoni që të mos i fitoni për çdo ditë nga njëmijë të mira? Njëri prej atyre që ishin në kuvend i thotë: Si mund t'i fitojmë nga njëmijë shpërblime. Muhamedi a.s. i përgjigjet: E thotë TESBIHUN njëmijë herë dhe i shkruhen njëmijë shpërblime, si dhe i shlyhen njëmijë gabime.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 80:**

*Transmetohet nga Sead Ibn Vekasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A nuk ka mundësi asnjëri prej jush që t'i fitojë për çdo ditë nga 100 sevabe (të mira) ?

Njëri prej nesh e pyeti. Po si mund t'i fitojë ndonjëri prej neve 1000 sevabe (të mira)?

U përgjigj i Dërguari: E lavdëron Zotin (SUBHANELLAH) 100 herë, e atij i shkruhen 1000 sevabe (të mira), ose i fshihen 1000 gabime.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 81:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Djali mund t'ia paguajë babait borxhin, nëse babai është rob, e blen edhe pastaj e liron.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 82:**

*Transmetohet nga Ebu Hurjre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtetë Zoti i Madhëruar dërgon melekë në tokë për të kontrolluar rrugët dhe për t'i kërkuar ata të cilët e përkujtojnë All-llahun. Kur të takojnë popullin, i cili e përkujton All-llahun, thonë: Kërkoni çka ju nevojitet dhe i mbulojnë me krahët e tyre në qiell, Zoti i Madhëruar e di, por prapë i pyet Melekët,

- Çka thonë robërit e mi?

- SUBHANALLAH, ELHAMDULILAH, ALL-LLAHU EKBER.

- A më kanë parë?

- Jo, për Zotin, nuk të kanë parë.

- Po si do të vepronin nëse më shohin?

- Sikur të të shohin, do të të adhuronin më shumë, do të të falënderonin më shumë dhe do të të lavdëronin më shumë.

Pastaj Zoti i Madhëruar i pyet Melekët:

- Çka kërkojnë prej Meje?



Kërkojnë xhenetin.

- A e kanë parë?

- Jo, për Zotin nuk e kanë parë.

- Po sikur ta shihnin?

- Sikur ta kishin parë do ta lakmonin më shumë, do ta dëshironin më shumë dhe do ta kërkonin më shumë.

Pastaj Zoti prapë i pyet Melekët:

- Nga çka kërkojnë mbrojtje?

Nga zjarri.

- A e kanë parë?

Jo, për Zotin, nuk e kanë parë.

- Po sikur ta shihnin?

- Sikur ta kishin parë do të frikësoheshin më shumë prej tij dhe do të largoheshin më shumë nga rruga e cila shpie atje.

Zoti në fund thotë: - Dëshmoj para juve se ua kam falur atyre gabimin.

Një prej melekve thotë: - Në mesin e tyre është një njeri i cili ka ardhur për nevojë tjetër.

Zoti i Madhëruar thotë: - Ata janë një popull dhe të gjithë janë për një kuvendim.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 83:**

*Transmetohet nga Ebil Halimi bin Abdullahi bin Harithi bin Sefetil Ensariju r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur kalimtari para falësit do ta dinte se sa është gabim, do të qëndronte pa kaluar para tij katërdhjetë, për të qenë më mirë për të. (Pastaj transmetuesi thotë) Nuk e di se me fjalën katërdhjetë a ka pasur qëllim 40 ditë, 40 muaj apo 40 vite.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 84:**

*Transmetohet nga Ajshja se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Farefisnia është e ndërlidhur me arshin dhe thotë:

- Kush i përforcon marrëdhëniet farefisnore, Zoti i përforcon marrëdhëniet me të,
- Kush i ndërpreu marrëdhëniet farefisnore, Zoti i ndërpreu marrëdhëniet me të.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 85:**

*Transmetohet nga Umer Ibn Hatabi se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur personi merr abdest dhe thotë:

Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka Zot tjetër përpos All-llahut dhe nuk ka shok as rival, dëshmoj se Muhamedi është rob i Zotit dhe i Dërguari i Tij, Zoti ia çel atij 8 dyert e xhenetit dhe hyn në cilën derë të dëshirojë.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 86:**

*Transmetohet nga nëna e besimtarëve Habibe binte Ebi Sufjan r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdo musliman i cili për çdo ditë i fal për Zotin nga 12 rekate nafile namaz, Zoti ia ndërton një shtëpi në xhenet, me fjalë tjera i sigurohet (ndërtohet) atij një shtëpi në xhenet.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 87:**

*Transmetohet nga Hudhejfe Ebi Dherri r.a. se Muhamedi a.s. kur shtrihej në shtrat thoshte:*

Me emrin e Zotit tim ngjallem dhe vdes.

Ndërsa kur ngrihej thoshte:

Falënderimi i takon Zotit, i cili na ka ngjallur pasi që ishim të vdekur dhe te Ai do të kthehemi.

BUHARIU |

### **Hadithi - 88:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. thoshte në dua:*

Zoti im! Kërkoj mbështetje nga e keqja të cilën e kam bërë dhe nuk e kam bërë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 89:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur mblidhen njerëzit në vendkuvendime për të përkujtuar Allahun, Zoti u dërgon atyre Melekët, lëshon mëshirën e Tij dhe qetësi, si dhe i përkujton me të mirë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 90:**

*Transmetohet nga Ebi Musa Eshariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A dëshironi t'ju tregoj thesarin prej thesareve të xhenetit.

I thashë: Po, o i Dërguari i Zotit?

U përgjigj: (lutja) LA HAULA VE LA KUVET ILA BILAH.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 91:**

*Transmetohet nga Keab bin Uxhrete r.a. se i Dërguari All-llahut (s.a.v.s.) ka thënë:*

Lutjet pas namazit, të cilat i thotë falësi pas çdo namazi farz, janë:  
33 herë SUBHANELLAH,  
33 herë ELHAMDULILAH dhe  
34 herë ALL-LLAHU EKBER.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 92:**

*Transmetohet nga Mugirete ibn Sheab r.a. se Muhamedi a.s. kur e përfundonte namazin thoshte:*

LA ILAHE IL-LALLAHU VAHDEHU LA SHERIKE LEHUL  
MULKU VE LEHUL HAMDU VE HUVE ALA KUL-LI SHEJIN  
KADIJR.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 93:**

*Transmetohet nga Ebu Dherri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A dëshironi t'ju tregoj për fjalët më të dashura tek All-llahu?

Fjalët më të dashura tek All-llahu janë: SUBHANELLAHI VE BI  
HAMDIHI.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 94:**

*Transmetohet nga Abdullah Taik bin Eshijm r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush thotë LA ILAHE IL-LALL-LLAH dhe nuk beson në dikë  
tjetër përpos Zotit, i ndalohet atij gjakderdhja, por edhe llogaria e tij në  
ditën e gjykimit.

**Hadithi - 95:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush pendohet deri para se të lind dielli nga perëndimi, Zoti do t'ia pranojë tevben (pendimin) atij.

MUSLIMI

**Hadithi - 96:**

*Transmetohet nga Ebi Jahja bin Suhejbi bin Senan r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çudi është çështja e besimtarit, çdo gjë është në dobi të tij, çka nuk është te askush tjetër përpos besimtarëve.

Nëse i ndodh ndonjë vështirësi apo fatkeqësi, duron, e ajo është në dobi të tij.

Nëse i ndodh ndonjë fatmirësi, falënderon, e ajo është në dobi të tij.

MUSLIMI

**Hadithi - 97:**

*Transmetohet nga Ebi Said dhe Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çfarëdo problemi që i ndodh besimtarit prej lodhjes, sëmundjes, mërzi, pikëllimit, ofendimit dhe çdo sëmundje tjetër, Zoti ia fshin gabimet e tij.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 98:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:*

Vërtet All-llahu i Lartmadhëruar nuk e do njeriun, i cili vepron atë që e ka ndaluar dhe e ka bërë haram All-llahu.

**Hadithi - 99:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti im! Kërkoj prej Teje udhëzim e devotshmëri, shëndet dhe pasuri.

MUSLIMI

**Hadithi - 100:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shpejtoni në vepra të mira në momentet (në kohërat) e sundimit të errësirës dhe padrejtësisë, kur njeriu në mbrëmje është besimtar e në mëngjes bëhet pabesimtar; ose në mëngjes është besimtar e në mbrëmje bëhet pabesimtar. E shet fenë e tij për pasurinë e kësaj bote.

MUSLIMI

**Hadithi - 101:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se në betejën e Uhudit një njeri e ka pyetur Muhamedin a.s.:*

Po sikur të vritesha, ku do të shkoj unë. Muhamedi a.s. i tha: Në xhenet. Ai njeri kishte hurma në dorë të cilat i ka hedhur menjëherë dhe ka shkuar në front derisa është vvarë.

MUTEFIKUN ALEJHI

### **Hadithi - 102:**

*Transmetohet nga shërbëtori i të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. Ebi Rebia bin Keab el Eslenu r.a. i cili ka thënë:*

Një natë kam qëndruar me të Dërguarin e All-llahut; përpos që i kam ofruar ujë për abdest, i kam ofruar edhe ndihma të tjera, e ai më ka thënë: Kërko diçka?.

E kam pyetur: A mund të të shoqëroj edhe në xhenet. Më ka pyetur: Po, por edhe diçka tjetër pas kësaj. I kam thënë: Asgjë tjetër pos kësaj.

Pastaj Muhamedi a.s. më ka thënë: Kujdesu që ta kesh vazhdimisht kokën në sexhde.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 103:**

*Transmetohet nga ana e Abdullahi Ebi Abdu Rrahman Thuban Mevla r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Bjer në sexhde vazhdimisht. Sepse çdo herë kur të biesh në sexhde, Zoti për një shkallë të ngritë lart dhe të fshin gabimet.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 104:**

*Transmetohet nga Ebu Dherri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Më janë paraqitur veprat e umetit tim, të mirat dhe të këqijat.

Kam parë se prej veprave të mira ishte edhe largimi i mbeturinave prej rrugës.

Pastaj kam parë se prej veprave të këqija është vajtimi për të vdekurin, i cili ishte në xhami dhe ende nuk ishte varrosur.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 105:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

E kam parë njeriun duke qëndruar në xhenet për shkak se e kishte hequr lisin, i cili kishte qenë në mes të rrugës dhe kishte penguar udhëtarët muslimanë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 106:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush merr abdest dhe e plotëson atë, pastaj shkon për të falë namazin e xhumasë, e dëgjon hutben me vëmendje dhe hesht, i falen atij deri në atë namaz të xhumasë edhe tre ditë tjera; dhe kush luan me shkop, ai e ka prishur.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 107:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A dëshironi t'ju tregoj për diçka për të cilën Zoti jua fshin gabimet dhe ju ngrit në shkallë të lartë.

I thanë: Po, o i Dërguari i Zotit.

Tha: Plotësimi i abdestit në kohë të vështirë, shumimi i hapave deri në xhami dhe pritja e namazit pas namazit. Kjo është Ribat(ndërlidhëshmëri).

MUSLIMI |

### **Hadithi - 108:**

*Transmetohet nga Ebi Musa Eshariu se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush i fal (dy namazet) Sabahun dhe Ikindinë, do të hyjë në xhenet.



**Hadithi - 109:**

*Transmetohet nga Ebu Musa Eshariu se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të sëmuret robi apo është udhëtar, i shënohen obligimet e kryera sikur të kishte qenë i shëndoshë.

BUHARIU |

**Hadithi - 110:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur muslimani e mbjell një pemë, çka hahet prej asaj peme i llogaritet lëmoshë, çka vidhet prej asaj peme i llogaritet lëmoshë, çka pakësohet prej asaj peme i llogaritet lëmoshë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 111:**

*Transmetohet nga Adi bin Et'hem r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Frikësohuni nga zjarri i xhehenemit, edhe nëse është në pyetje një hurme.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 112:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Secili prej Umetit tim do të hyjë në xhenet, përpos Refuzuesit.

Është pyetur: Po kush është ai i cili refuzon?

(Muhamedi a.s. ka thënë:) Kush i dëgjon dhe i nënshtrohet urdhrave të mia, do të hyjë në xhenet, kush i kundërshton dhe nuk i nënshtrohet urdhrave të mia, nuk do të hyjë në xhenet.

BUHARIU |

### **Hadithi - 113:**

*Transmetohet nga Ebi Mesudi Ukbëte Ibn Amri Ensariu Bedriu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush udhëzon në të mirë, atij i shënohen shpërblimet e bamirësit sikur ti kishte bërë vet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 114:**

*Transmetohet nga Enes bin Maliku r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk ka besuar askush prej jush, derisa mos të dëshirojë për vëllanë e tij atë që e dëshiron për vete.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 115:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi Hudri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Keni kujdes nga ulja nëpër rrugë.

I thamë: O i Dërguar i Zotit, por ne duhet që patjetër t'i përmbahemi deri sa jemi në rrugë.

I Dërguari i Zotit tha: Kur të jeni në rrugë, jepjani rrugës të drejtën e saj.

I thamë: Po çka është e drejta e rrugës, o i Dërguar i Zotit?

Tha:

- Ulja e shikimit,
- mosofendimi,
- kthimi i selamit,
- urdhërimi në punë të mira dhe
- ndalimi nga punët e këqija.

**Hadithi - 116:**

*Transmetohet nga Zejd Usamete bin Zejd bin Harithi r.a. se e ka dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë:*

Në ditën e kijametit vjen një njeri dhe hidhet në zjarr, aty i dalin zorrët nga barku dhe i lidhen (i sillen) për trupi sikurse kur lidhet gomari me samar; aty tubohen banorët e xhehenemit dhe e pyesin: O filan, çka është puna me ty? A nuk ke urdhëruar për punë të mira dhe ke ndaluar nga punët e këqija.

Ndërsa ai përgjigjet: Po, kam urdhëruar në punë të mira dhe kam larguar prej punëve të këqija, por unë vet i kam vepruar ato.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 117:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ruajuni padrejtësisë, sepse padrejtësia është errësirë (terr) prej errësirave të ditës së gjykimit. Ruajuni koprracisë, sepse koprracia i ka shkatërruar ata të cilët kanë qenë para jush, se ka ndikuar në vrasje në mes vete dhe i kanë lejuar të ndaluarat.

MUSLIMI |

**Hadithi - 118:**

*Transmetohet nga Xheriri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush nuk i mëshiron njerëzit, Zoti nuk e mëshiron atë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 119:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjëri prej jush është udhëheqës i namazit, le të jetë i matur dhe të lehtësojë, sepse ka prej xhematit të sëmurë e pleq, ndërsa kur ndonjëri prej jush falet vetëm, le ta zgjatë sa të dëshirojë!

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 120:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çka të mbulojë robi për robin (njeriu për njeriun) në këtë botë, Zoti do t'i mbulojë atij në ditën e gjykimit.

MUSLIMI |

**Hadithi - 121:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush ndihmon të venë dhe të varfrit është sikur luftëtari në rrugën e Zotit dhe sikur ai që agjëron ditën dhe lutet natën.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 122:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Amr Ibn Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Jeta është kënaqësi dhe kënaqësia e jetës është bashkëshortja (gruaja) e mirë, e nderhme.

MUSLIMI |

**Hadithi - 123:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur burri thërret bashkëshorten e tij në shtrat e ajo nuk i përgjigjet, tërë natën e mallkojnë Melekët deri sa të agojë dita.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 124:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

- Dinarin të cilin e shpenzon në emër të Zotit.
- Dinarin të cilin e shpenzon për të liruar një rob.
- Dinarin të cilin e jep lëmoshë për të varfrit.
- Dinarin të cilin e shpenzon për familjen tënde.

Të gjitha kanë shpërblime, por shpërblimi më i madh të takon për atë çka e ke shpenzuar për familjen tënde.

MUSLIMI |

**Hadithi - 125:**

Ebi Abdu Rrahmani ibn Abdullah Ibn Mes'udi e ka pyetur Muhamedin a.s.:

Cilat vepra janë më të dashura te Zoti?

U përgjigj: Namazi në kohën e tij.

Pastaj?

Respektimi dhe nderimi i prindërve.

Pastaj?

Xhihadi në rrugën e Zotit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 126:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush dëshiron që t'i zgjerohet furnizimi, le t'i përsosë marrëdhëniet fafaisnore.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 127:**

*Transmetohet nga Ebi Isa Ei Mugirete bin Sheab r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtetë Zoti ju ka ndaluar të silleni ashpër me prindërit tuaj, me kujdestarët tuaj dhe mbikëqyrësit tuaj dhe t'i varrosni vajzat e porsalindura për së gjalli; dhe i urren thashethemet, pyetjet e panevojshme e të tepërta dhe humbjen e pasurisë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 128:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Femra martohet për 4 gjëra:

- Për pasurinë e saj.
- Për fisin e saj.
- Për bukurinë e saj.
- Për fenë e saj.

Martohu me atë e cila është fetare, shpëtove nga shkatërrimi.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 129:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur Zoti i Madhëruar e do robin e Tij, thërret Xhibrilin dhe i thotë: Zoti e do filanin, pra duaje, dhe e do edhe Xhibrili, e Ai (Xhibrili) i thërret banorët (krijesat) e qiellit dhe u thotë: Zoti e do filanin, pra dojeni, dhe e duan banorët e qiellit, pastaj dashuria e tyre përcillet në tokë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 130:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti i madhëruar në ditën e gjykimit thotë:

Ku janë ata të cilët janë dashur në mes vete në emrin Tim. Sot do t'i strehoj nën hijen Time, ditën në të cilën nuk ka hije as strehim, përpos hijes Time.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 131:**

*Transmetohet nga Nuëman bin Beshijr r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Dënimi më i lehtë i banorëve të Xhehenemit në ditën e kijametit është të vendoset njeriu me këmbë mbi gaca të xhehenemit, e atij i vlojnë trutë prej nxehtësisë. Kjo edhe pse duket më e ashpra në këtë botë, në botën tjetër është më e lehta.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 132:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Muslimani i cili vdes dhe ia falin atij kufomën (namazin e xhenazes) 40 persona të cilët nuk i bëjnë shok Zotit, Zoti do t'i bëjë shefa'at atij (do t'ia lehtësojë dënimin).

MUSLIMI |

### **Hadithi - 133:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur ta dinte besimtari dënimin e Zotit, kurrë nuk do të shpresonte xhenetin.

Sikur pabesimtari ta dinte mëshirën e Zotit, kurrë nuk do të humbte shpresën për xhenet.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 134:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Xheneti është më afër se sa thembra e këpucëve, edhe xhehenemi po ashtu.

BUHARIU |

### **Hadithi - 135:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shtatë persona do të vendosen nën hijen e All-llahut në ditën ku nuk ka hije tjetër, përpos hijes së tij:

- Udhëheqësi i drejtë;
- I riu i rritur në adhurimin e All-llahut;
- Njeriu, zemra e të cilit është e ndërlidhur me xhami;
- Dy njerëz që duhen dhe bashkohen në emër të All-llahut;
- Njeriu, të cilin e thërret një femër fisnike dhe e bukur, e ai e refuzon e thotë: Unë i frikësohem All-llahut;
- Njeriu, i cili jep sadaka, sa dora e djathtë nuk e di çka ka dhënë dora e majtë; dhe
- Njeriu, i cili kur e përkujton All-llahun i pikojnë lotët.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 136:**



*Transmetohet nga Ebi Said el Hudrij se:*

U ul Muhamedi a.s. në shtrojë dhe ne u afuam pranë tij, e ai tha:

Më së shumti nga çka frikësohem për ju (pas meje) është për atë se do të ju hapen dyert e bukurisë dhe hijeshisë së kësaj bote.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 137:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Të vdekurin (kufomën ) e përcjellin tri gjëra:

- Familja e tij,
- pasuria e tij dhe,
- vepra (veprat) e tij,

dy kthehen e njëra mbetet, familja dhe pasuria e tij kthehen, mbetet vetëm vepra (veprat) e tij.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 138:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shikoni në atë i cili është më poshtë se ju dhe mos shikoni në atë i cili është më lartë se ju; kjo është më e mirë që të mos e largoni bekimin e Zotit ndaj jush.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 139:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kjo botë është burg i besimtarit dhe xhenet i pabesimtarit.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 140:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi dhe Umran Ib Husejn r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

I bëra një shikim xhenetit, pashë se shumica e tyre ishin të varfër.

I bëra një shikim xhehenemit, pashë se shumica e tyre ishin gra.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 141:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk është pasuri grumbullimi i kapitalit, por pasuri e vërtetë është pasurimi i shpirtit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 142:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ka shpëtuar ai i cili ka lindur musliman dhe i verbër, mirëpo që është kënaqur me atë çka i ka dhënë Zoti.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 143:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zilia mund të bëhet vetëm në dy persona:

- Njeriut të cilit i ka dhënë Zoti pasuri dhe ai e udhëheq drejt dhe e shpenzon në rrugë të drejtë;

- Njeriut të cilit i ka dhënë Zoti dituri dhe vepron sipas ditorisë dhe i mëson tjerët.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 144:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Për çdo mëngjes, kur të ngrihet njeriu, i zbresin dy Melekë dhe njëri prej tyre thotë:

O Zot i Madhëruar, furnizuesit (atij që jep sadaka) shtoja pasurinë.  
(Tjetri thotë) O Zot i Madhëruar, koprracit humbja pasurinë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 145:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti i Madhëruar thotë:

O biri Ademit, shpenzo se do të shpenzohet për ty.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 146:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr Ibn Asi r.a. se:*

Një njeri e ka pyetur Muhamedin a.s.:

Çka është më e vlefshme në Islam?

U përgjigj: Të ushqesh nevojtarin, t'i japësh selam atij të cilin e njeh, dhe atij të cilin nuk e njeh.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 147:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk pakësohet pasuria me dhënien e sadakasë;

kush ia fal gabimet (tjetrit), Zoti e lartëson,

kush i nënshtrohet All-llahut, Ai e ngrit personalitetin e tij.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 148:**

*Transmetohet nga Ibn Amr r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk ka zili vetëm se në dy persona:

Njeriut të cilit i ka dhënë Zoti (njohuri) Kur'anin dhe ai falet dhe i përmbahet gjatë ditës e natës.

Njeriut të cilit i ka dhënë Zoti pasuri e ai e shpërndan ditën e natën.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 149:**

*Transmeton Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

E drejtë e muslimanit është që kur t'i lihet testament diçka, e ai veç ka pritur dy net, testamenti duhet t'i jepet (sa më parë), sepse për atë është lënë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 150:**

*Transmetohet nga Sead Ibn Vekasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në të vërtetë Zoti e do robin modest, të devotshëm, të pastër në zemër dhe të fshehur.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 151:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi r.a. se një njeri e ka pyetur Muhamedin a.s.:*

Cilët njerëz janë më të vlefshëm, o i Dërguari i Zotit.

U përgjigj: Besimtari i cili e angazhon veten dhe pasurinë e tij në rrugë të Zotit.

Po pastaj cilët?

U përgjigj: Ai i cili ngjitet në ndonjë shpat prej shpateve për të adhuruar All-llahun...(në një transmetim tjetër) ...I frikësohet All-llahut dhe janë të sigurt njerëzit prej të keqes së tij.

**Hadithi - 152:**

*Transmetohet nga Ajad bin Hamari r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti më ka urdhëruar që ju të jeni të devotshëm, sa që të mos të krenohet asnjëri ndaj tjetrit dhe të mos bëjë krim asnjëri ndaj tjetrit.

MUSLIMI |

**Hadithi - 153:**

*Transmetohet nga Helmete bin el-Kuë r.a. se një njeri para të Dërguarit hante me dorën e majtë e Muhamedi a.s. i tha: Ha me dorën e djathtë.*

Ai iu përgjigj. Nuk mundem, e Muhamedi a.s. i tha: Nuk të pengon asgjë (të hash me dorën e djathtë) përpos kryelartësia.

Pre atij momenti ai njeri nuk mund ta zgjaste dorën deri në gojën e tij.

MUSLIMI |

**Hadithi - 154:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se i Dërguari i All-llahut ka thënë:*

Në ditën e kijametit Zoti i Madhëruar nuk do ta shikojë atë i cili e lëshon këmishën nën mëngët e këmbës me kryelartësi.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 155:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejrete r.a. se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë:*

All-llahu i Lartmadhëruar ka thënë:

Forca, Madhështia dhe Bujaria janë cilësi të Mia, por kush në këto çështje më kundërshton, do ta dënoj.

**Hadithi - 156:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Lehtësoni, mos vështirësoni,  
përgëzoni dhe mos mallkoni.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 157:**

*Transmetohet nga Xherir bin Abdullahi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk i është dhënë zemërbutësia, i janë ndaluar të gjitha të mirat.

MUSLIMI

**Hadithi - 158:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk është trimëri me përleshje (dyluftim), por trimëri është të sunduarit e vetvetes në rast hidhërimi.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 159:**

*Transmetohet nga Abdullah ibn Amr Ibn Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Allahu do t'i vendosë në ulëse prej dritës të drejtit, ata të cilët gjykojnë drejt, të drejtit në familje dhe në çdo punë çka u besohet atyre.

MUSLIMI

### **Hadithi - 160:**

*Transmetohet nga Ajad ibn Hamar r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Banorët e xhenetit janë tri llojesh:

- Sundimtari i drejtë.
- Njeriu i mëshirshëm dhe zemërbutë për çdokënd, qoftë i familjes apo i huaj.
- Besniku, i thjeshti dhe i drejti në familjen e tij.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 161:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush urren nga udhëheqësit e tij diçka, le të durojë, sepse kush largohet nga udhëheqësi një pëllëmbë, do të vdesë, vdekje të injorancës.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 162:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Imani i ka shtatëdhjetë e disa apo gjashtëdhjetë e disa degë, e më e vlefshmja e tyre është fjala LA ILAHE IL-LALLAH dhe e fundit është largimi i ndyrësirës nga rruga, e Turpi është degë e imanit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 163:**

Transmetohet nga Ebi Seid el Hudriji r.a. se Muhamedi a.s. ka qenë më i turpshëm se vajza virgjëreshë. Nëse shihte diçka që nuk i pëlqente, e hetonim prej fytyrës së tij.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 164:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Shenjat e munafikut janë 3:

- kur të fletë, rren;
- kur të premton, tradhton;
- kur t'i besohet diçka, nuk e kryen.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 165:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Amr bin Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

O rob i Zotit, mos u bëj sikur filani, i cili qëndronte natën dhe (e linte) nuk e falte namazin natën.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 166:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Fjala e mirë është sadaka (lëmoshë).

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 167:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të jetë duke u falur namazi, mos shkoni duke vrapuar, por shkoni duke ecur normalisht dhe të qetë; çka të arrini, faleni, e çka nuk e arrini, plotësojeni.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 168:**



*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush beson në Zotin dhe në ditën e gjykimit, le të respektojë mysafirin.

Kush beson në Zotin dhe në ditën e gjykimit, le t'i përsosë marrëdhëniet farefisnore.

Kush beson në Zotin dhe në ditën e gjykimit, le të flasë fjalë të dobishme ose të heshtë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 169:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndokush i mbath (i vesh) këpucët, le të fillojë nga e djathta, kur t'i zbathë (zhveshë), le të fillojë nga e majta.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 170:**

*Transmetohet nga Ebi Uname r.a. se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. kur ngrihej tryeza (sofra) e tij thoshte:*

Falënderimi i takon All-llahut pa masë, të gjitha të mirat dhe bekimet i takojnë Atij, ndërsa Ai nuk ka nevojë për ushqim, as për asgjë, por Ai ushqen dhe jep çka të dëshirojë.

BUHARIU |

### **Hadithi - 171:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur t'ju thërret dikush (në ushqim), përgjigjuni, nëse jeni agjërueshëm, mos hani, e nëse nuk jeni agjërueshëm, ushqehuni.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 172:**

*Transmetohet nga Umer Ibn Selme r.a. se ka thënë:*

Kam qenë në shërbim të të Dërguarit dhe dora ime gjatë ushqimit kalonte pranë të tjerëve dhe mua i Dërguari i All-llahut më tha: O djalosh: Përkujtoje All-llahun. Ha me dorën e djathtë dhe çka ke pranë e të takon.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 173:**

*Transmetohet nga Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjëri prej jush han ushqim, le të mos e fshijë gishtin e tij, derisa të mos e fshijë me buzët e tij, ose derisa të mos ia fshinë atij.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 174:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjërit prej jush i bie pjesa e bukës në tokë, le ta marrë, le ta fshijë pluhurin prej saj dhe mos t'ia lërë shejtanit, mos ta fshijë dorën e tij me faculetë, para se ta fshijë gishtin e tij me buzët e tij, sepse ai nuk e di se në cilën pjesë të bukës është e mira dhe bekimi i Zotit.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 175:**

*Transmetohet nga Umu Seleme r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush pi nga ena prej argjendit, ai e ka mbushur barkun e tij me zjarrin e xhehenemit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 176:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çka të jetë më poshtë se zogu i këmbës, do të digjet në zjarr.

BUHARIU

**Hadithi - 177:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se:*

Muhamedi a.s. prej mbrëmjes e deri sa gdhinte agimi i falte 11 rekate, pastaj i falte 2 rekate të lehta, pastaj shtrihej në krahun e djathtë derisa Muezini e thërrite ezanin e sabahut.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 178:**

*Transmetohet nga Ibn Umer r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndokush ngrihet nga vendtubimi, mos t'ia zërë vendin e tij askush, por zgjerohuni, lironi vend për njëri-tjetrin.

Ibn Umeri e ka pas traditë mos të ulet në vendin e tjetrit.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 179:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të largohet (ngrihet) dikush nga Kuvendimi, pastaj kthehet, ai më së shumti ka të drejtë për vendin e tij.

MUSLIMI

**Hadithi - 180:**

*Transmetohet nga Ebi Abdullah Ibn Selmani r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur njeriu pastrohet ditën e xhumasë dhe rregullohet me atë çka ka mundësi (dhe ajroset),

pastaj e rregullon dhe e ajros shtëpinë,

del dhe nuk bën dallim në askënd,

fal atë çka është obligim,

hesht derisa Imami ligjëron,  
do t'i falen gabimet e tij prej xhumasë deri në xhumanë tjetër.

BUHARIU |

**Hadithi - 181:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Pas peygamberllëkut nuk ka mbetur asgjë përpos përgëzimeve.

E kanë pyetur: Çka janë përgëzimet?

Ai është përgjigjur: Ëndrrat e mira dhe të vërteta.

BUHARIU |

**Hadithi - 182:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Do të afrohet (vijë) koha kur ëndrra e besimtarit do të jetë e vërtetë (realizohet), sepse ëndrra e besimtarit është pjesë e 46 pjesëve të peygamberllëkut.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 183:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush më sheh në ëndërr, ai do të më shohë zgjuar, ose sikur të më ketë parë me të vërtetë, sepse shejtani nuk mund të shndërrohet në figurën time.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 184:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi Hudrij r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjëri prej jush sheh ndonjë ëndërr, e cila i pëlqen, ajo është prej Zotit, e le ta falënderojë Zotin dhe le ta tregojë atë...(në një transmetim tjetër) mos t'ia tregojë vetëm se atij të cilin e do; po në qoftë se sheh ndonjë ëndërr, e cila nuk i pëlqen, ajo është prej

shejtanit, le të kërkojë mbështetje prej Zotit nga e keqja e saj dhe mos t'ia tregojë askujt, sepse ajo nuk i dëmton.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 185:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur e ka krijuar All-llahu Ademin a.s. i ka thënë:

Shko dhe jepu selam atyre melekëve ulur dhe dëgjo me vëmendje se si do të të përshëndesin ty dhe pasardhësit tu.

Shkon Ademi a.s. dhe i përshëndet *Eselamu alejkum* ndërsa Ata ia kthejnë përshëndetjen *Alejkum selam ve Rahmetullah*.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 186:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në ditën e Kijametit All-llahu i LartMadhërishëm i thotë birit të Ademit:

Jam sëmure e nuk më ke vizituar.

Njeriu thotë: O Zoti im, si të të vizitoj kur Ti je Zot i të gjithë botëve.

Zoti i Madhërishëm thotë: A nuk e ke ditur se filani, robi im, ka qenë i sëmure dhe nuk e ke vizituar?! A nuk e ke ditur se sikur ta kishe vizituar do të më kishe takuar atje tek ai?!

O biri Ademit: Të kam kërkuar ushqim nuk më ke ushqyer.

Njeriu i thotë: O Zoti im, si të të ushqej kur Ti je Zot i të gjithë botëve?!

Zoti i Madhëruar thotë: A nuk e ke ditur se filani, robi im, kur të ka kërkuar ushqim (të kam kërkuar Unë t'i japësh atij)? A nuk e ke ditur se sikur t'i ndihmoje me ushqim, atë shpërblim do ta kishe të siguruar tek Unë?

O biri Ademit: Të kam kërkuar ujë të pi e nuk me ke dhënë.

Njeriu thotë: O Zoti im, si të të jap ujë të pish kur Ti je Zot i të gjithë botëve?!

Zoti i Madhëruar thotë: Filani, robi Im, të ka kërkuar ujë të pijë dhe nuk i ke dhënë. A nuk e ke ditur se sikur ta ndihmoje atë të pi ujë, shpërblim do ta kishe të siguruar tek Unë?

MUSLIMI

**Hadithi - 187:**

*Transmetohet nga Ebi Musa r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

*Vizitoheni të sëmurin, ushqejeni të uriturin dhe lirojeni robin.*

BUHARIU

**Hadithi - 188:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s.:*

I vizitonte të sëmuret (prej familjes tij), i prekte me dorën e djathtë të tij dhe thoshte: O Zoti im, Krijues i njerëzve, largoje sëmundjen dhe shëroje. Ti je shërues, nuk ka shërues përpos Teje, shërim të cilën nuk e kap sëmundja.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 189:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e viziton të sëmurin nëse atij nuk i ka ardhur caktimi i vdekjes, dhe vizitori thotë shtatë herë: Kërkoj prej Zotit të Madhëruar, Krijues i arshit të madh, që të të shërojë, Zoti i shëron nga ajo sëmundje.

SAHIJ ALA SHART BUHARIJ

**Hadithi - 190:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e përcjell kufomën e muslimanit me besim të plotë, me shpresë se e shpërblen Zoti i Madhëruar dhe qëndron aty deri sa t'i falet namazi, dhe ia fal namazin e xhenazes, ai shpërblehet me dy Kirate. Shpërblimi i secilit Kirat është që peshon sa Kodra e Uhudit.

Ndërsa, kush ia fal namazin e xhenazes dhe nuk e përcjell dhe nuk qëndron deri në varrimin e tij, ai kthehet me shpërblim të një Kiratit.

BUHARIU |

#### **Hadithi - 191:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdo muslimanit të cilit ia falin namazin njëqind musliman dhe luten për të, lutja e tyre për të është e pranuar.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 192:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shpejtoni në përcjelljen e kufomës, sepse nëse është i mirë, është më mirë për të, se ai e dëshiron, e nëse jo, pra është i keq, është vështirë për të.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 193:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdo muslimani të cilit i vdesin tre fëmijë para moshës madhore, All-llahu do ta shpërblejë me xhenet prej mëshirës së All-llahut ndaj atyre fëmijëve të vdekur.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 194:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
*Sikur ta dinin njerëzit vlerën e Unitetit, askush nuk do të udhëtonte vetëm në kafshë gjatë natës.*

BUHARIU |

**Hadithi - 195:**

*Transmetohet nga Havlet bin Hakim r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush hyn në (shtëpi-banesë) vendbanim dhe thotë: Unë kërkoj mbrojtje nga fjala e ndëshkimit të All-llahut, nga e keqja e krijuar, nuk i ndodh e keqe deri sa të largohet nga ajo shtëpi.

MUSLIMI |

**Hadithi - 196:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ai i cili e këndon Kur'anin me precizitet dhe shkathtësi, ai do të jetë me Melekët e dalluara (Kiramîn Berere).

Por, edhe ai i cili nuk e këndon Kur'anin me precizitet dhe shkathtësi, por e lexon me vështirësi, prapëseprapë do të ketë shpërblim.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 197:**

*Transmetohet nga Ebi Musa Eshariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Besimtari i cili këndon Kur'an është si pema, e cila edhe erën edhe shijen e ka të mirë.



Besimtari i cili nuk këndon Kur'an është si pema, e cila nuk ka erë, por shijen e ka të mirë.

Dyftytërsi i cili këndon Kur'an është si pema, e cila erën e ka të mirë por shijen e ithët.

Dyftytërsi i cili nuk këndon Kur'an është si pema e cila as nuk ka erë, por edhe shijen e ka të ithët.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 198:**

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. për KUL-HUVALLAHUN ka thënë se *ajo është e barabartë me një të tretën e Kur'anit.*

MUSLIMI |

### **Hadithi - 199:**

Transmetohet nga Ebi Musudi Bedrij r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:

Kush i këndon dy ajetet e fundit të suretul-BEKARE, i mjaftojnë atij për atë mbrëmje.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 200:**

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:

Mos i bëni shtëpitë e juaja varreza, në të vërtetë shejtani ikën nga shtëpia në të cilën këndohet suretul BEKARE.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 201:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të mblidhen njerëzit në shtëpi prej shtëpive të Zotit, këndojnë librin e Zotit dhe e mësojnë atë, atyre u zbret qetësi dhe Zoti i mbulon me mëshirën e Tij.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 202:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Umeti im ditën e gjykimit do të jetë i ndriçuar duar e këmbë nga (uji) shenjat e abdestit. Kush dëshiron, është mirë t'i pastrojë pjesët e trupit (këmbë e duar) gjatë marrjes së abdestit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 203:**

*Transmetohet nga Uthman Ibn Afan r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush merr abdest dhe plotëson atë, i fshihen apo i dalin atij gabimet nga trupi.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 204:**

*Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush shkon në xhami apo qëndron një pjesë të natës apo të ditës në xhami, All-llahu i përgatit vend në xhenet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 205:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush thotë pas përfundimit të ezanit:

Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përpos All-llahut, nuk ka shok, dhe se Muhamedi është i Dërguar i tij dhe Rob i tij, jam i kënaqur se All-llahu është Zoti im, Muhamedi a.s. është i Dërguar dhe jam i kënaqur se i takoj fesë Islame, i falen atij gabimet e mëparshme.

BUHARIU |

#### **Hadithi - 206:**

*Transmetohet nga Sead Ibn Vekasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush thotë me rastin e këndimit të ezanit:

Dëshmoj se vetëm All-llahu është Zot dhe nuk ka shok, as rival, dhe Muhamedi rob dhe i Dërguari i Tij, jam i kënaqur se e kam pranuar All-llahun Zot timin, dhe Muhamedin peygamber dhe Islamin fe, i falen atij gabimet.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 207:**

*Transmetohet nga Ebi Zubejr Amr r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush falet para lindjes së diellit dhe para perëndimit (ka për qëllim namazin e ikindisë), nuk do të hyjë në zjarr të xhehenemit.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 208:**

*Transmetohet nga Ebu Musa r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shpërblimin më të madh në faljen e Namazit në Xhami e ka ai, i cili ka qenë më së largu dhe ka ecur më së shumti.

Ai i cili e pret namazin ta falë me Imamin, ka shpërblim më të madh se ai i cili është falur dhe ka fjetur.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 209:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a se Muhamedi a.s ka thënë:*

Ka prej jush të cilët janë në namaz, të cilët nuk vonohen për të shkuar në familjet e tyre, por vetëm namazi i pengon dhe i ndalon, dhe asgjë tjetër, për të shkuar në kohë në familjet e tyre.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 210:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Melekët bëjnë dua dhe kërkojnë faljen e gabimeve për personin deri sa ai është në xhaminë në të cilën është falur, dhe thonë:

O Zot i gjithësisë, falja gabimet. O Zot i gjithësisë, mëshiroje.

BUHARIU |

### **Hadithi - 211:**

*Transmetohet nga Uthman bin Afani r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush fal jacinë me xhemat, sikur të kishte falur gjysmën e natës, dhe

kush fal sabahun me xhemat, sikur të kishte falur tërë natën.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 212:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur ta dinin çka ka (vleftën) në namazin e jaxisë dhe të sabahut, njerëzit do të shkonin për tu falur duke u zvarritur.

**Hadithi - 213:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Për munafikët gjëja më e vështirë është namazi i sabahut dhe i jacisë; po sikur ta dinin çka ka në këto dy namaze, do të shkonin në xhami duke u zvarritur.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 214:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ndërmjet njeriut, pabesimit dhe idhujtarisë qëndron lënia e namazit.

MUSLIMI

**Hadithi - 215:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur ta dinin njerëzit vlerën e Ezanit dhe faljes së namazit në safin (rreshtin) e parë, ata do të hidhnin short vetëm e vetëm që të falen në safin e parë.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 216:**

*Transmetohet nga Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Radha më e vlefshme e burrave është radha e parë,  
ndërsa radha më e dëmshme e tyre është radha e fundit.

Radha më e vlefshme e femrave (grave) është radha e fundit,

ndërsa radha më e dëmshme e tyre është radha e parë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 217:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Drejtoni radhët e juaja, sepse, në të vërtetë, radhitja në namaz e plotëson namazin. Në transmetimin e Buhariut (në të vërtetë radhitja e radhëve në namaz është plotësimi i namazit).

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 218:**

*Transmetohet nga Nuëman bin Beshijr r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ose do t'i drejtoni radhët, ose nuk e keni ju ndihmën e Zotit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 219:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Muggel se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në mes të çdo thirrjeve (ezaneve) ka namaz, në mes të çdo dy ezaneve namaz. Në të tretën ka thënë: Kush dëshiron.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 220:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Dy rekatet e sabahut janë më të vlefshme se kjo botë dhe çka ka në të, (në një transmetim tjetër) është më e dashur për mua se çka ka në botë në përgjithësi.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 221:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s.:*

Në dy rekatet e sabahut këndonte:

KUL JA EUHEL KJAFIRUN dhe KUL HUVALLAHU EHAD.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 222:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjëri prej jush e fal namazin e xhumasë, le të falë pastaj edhe katër rekate.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 223:**

*Transmetohet nga Zajd Ibn sabiti r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

O njerëz, faluni në shtëpitë tuaja, sepse namazi më i vlefshëm është falja e namazit në shtëpi, përpos namazeve farze.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 224:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjëri nga ju e përfundon namazin e tij në xhaminë e tij, le të lërë një pjesë (pra le të falet prej namazit të tij) për në shtëpinë e tij, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë shumë të mira për falje të namazit edhe në shtëpi.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 225:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Namazi i fundit i mbrëmjes është namazi i vitrit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 226:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush frikësohet se nuk do të zgjohet në fund të natës (në mes të natës), le ta falë namazin e vitrit; kush është i sigurt se mund ta falë në mesnatë, le ta falë në mesnatë, sepse namazi i mesnatës është Dëshmi dhe kjo është më e vlefshme.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 227:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s.:*

Më ka këshilluar i dashuri Muhamedi a.s. për të agjëruar tri ditë të çdo muaji, dy rekatet e drekës, dhe të fal namazin e vitrit para se të shtrihem për të fjetur.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 228:**

*Transmetohet nga Ebi Katade r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të hyjë ndokush prej jush në një xhami për herë të parë, mos të ulet pa i falur dy rekatet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 229:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

- Falja e pesë kohëve,
  - namazi i xhumasë deri në namazin e xhumasë,
  - agjërimi i Ramazanit deri në agjërim të Ramazanit,
- i fshijnë gabimet, përpos gabimeve të mëdha.

MUSLIMI |



### **Hadithi - 230:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Deri sa jeni fjetur shejtani ndërlidh në kokët e juaja tri lidhëse dhe në secilën lidhëse thotë: Qoftë nata e gjatë për ju, shtrihu, nëse ngrihet dhe e përkujton Zotin, zgjidhet nyja (lidhëza) e parë, nëse merr abdes zgjidhet nyja e dytë, nëse falet, zgjidhet nyja e tretë dhe njeriu bëhet aktiv, zemërmirë, i sjellshëm, në të kundërtën bëhet i keq dhe përtac (dembel).

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 231:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush falet në (mbrëmje) Ramazan me besim të plotë dhe me shpresë të fortë në All-llahun, i falen gabimet e mëparshme.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 232:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur të mos frikësohesha se do të ngarkoj shumë popullin tim, do t'i kisha urdhëruar për përdorimin e misvakut para çdo namazi.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 233:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Pesë çështje janë prej çështjeve të natyrshmërisë dhe pastërtisë, e ato janë:

- Sunetija,
- të rruarit e nënsqetullave,
- prerja e thonjve,
- rruarja rreth organeve të turpshme dhe
- prerja e mustaqeve.

**Hadithi - 234:**

*Transmetohet nga Ibn Amri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Shkurtoni mustaqet dhe lini mjekrat.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 235:**

*Transmetohet nga Ebu Ejubi r.a. se një njeri ka pyetur Muhamedin a.s.:*

Më trego për një vepër, e cila do të më shtijë në xhenet?,

I Dërguari u përgjigj: Adhuroje vetëm Zotin, mos i bëj shok atij, fale namazin, jepe zekatin dhe përsosi marrëdhëniet farefisnore.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 236:**

*Transmetohet nga Sehl Ibn Sead r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në xhenet është një derë e ashtuquajtur Rejan, nga ajo derë do të hyjnë agjëruesit dhe askush tjetër përpos tyre. Ajo derë thotë: Ku janë agjëruesit dhe hyjnë vetëm agjëruesit, pastaj mbyllet dera dhe nuk lejon të hyjë askush tjetër.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 237:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi Hudri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur robi agjëron në emër të Zotit, Zoti e largon fytyrën e tij prej zjarrit të xhehenemit për shtatëdhjetë pranvera.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 238:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të vijë ramazani, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 239:**

*Transmetohet nga Sehl ibn Sead r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Njerëzit i përfshin e mira deri sa të shpejtojnë në iftar.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 240:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të agjërojë ndonjëri prej jush, mos të shajë dhe mos të thotë fjalë të këqija; nëse tjetri e ofendon, e shan ose dëshiron të ngatërrohet, le të thotë jam duke agjëruar.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 241:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nëse ndonjëri prej jush ha ose pi me harresë, le ta plotësojë agjërimin, sepse në të vërtetë e ka ushqyer All-llahu.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 242:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Pas agjërit të muajit Ramazan, agjërimi më i vlefshëm është agjërimi i muajit Muharrem.

Pas faljes së namazeve farze, namazi më i vlefshëm është namazi vullnetar i mesnatës.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 243:**

Transmetohet nga Ebu Katade r.a. se është pyetur Muhamedi a.s. për agjërimin në ditën e arafatit, e ai është përgjigjur:

I fshin gabimet e vitit të kaluar dhe të ardhshëm.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 244:**

*Transmetohet nga Ebi Katade r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Është pyetur për agjërimin në ditën e Ashuras.

Ai është përgjigjur: I fshinë gabimet e vitit të kaluar.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 245:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur të qëndroja në ditën e tetë (të dhulhixhes), do ta agjëroja ditën e nëntë (të DhulHixhes).

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 246:**

*Transmetohet nga Ebi Ejubi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e agjëron Ramazanin, pastaj edhe gjashtë ditë të muajit sheval, ka shpërblim sikur të kishte agjëruar tërë kohën.

MUTEFIKUN ALEJHI |

#### **Hadithi - 247:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e kryen Haxhin, nuk bën gabime dhe nuk ofendon, kthehet i pastër prej gabimeve sikur kur ka lindur prej nënës së tij.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 248:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. ka thënë:*

I Dërguari është pyetur: Cila vepër është më e vlefshmja?

Është përgjigjur: Të besuarit në Zotin dhe në të Dërguarin e Tij.

Pastaj cila?

Xhiahadi (lufta) në emër të Zotit.

Pastaj cila?

Haxhillëku i pranuar.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 249:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Prej Umres deri në Umre falen gabimet ndërmjet tyre, ndërsa

haxhi i pranuar shpërblehet në xhenet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 250:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se i është thënë Muhamedit a.s.:*

O i Dërguar i All-llahut, e shohim se vepra më e lavdëruar është lufta në rrugën e All-llahut, pse të mos luftojmë në rrugën e All-llahut?!

U përgjigj: Por më i lavdëruar është Haxhi i pranuar.

BUHARIU |

### **Hadithi - 251:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk ka ditë tjetër përpos ditës së Arafatit, në të cilën më së shumti Zoti i Lartmadhëruar i liron robërit e tij për t'u mos u djegur në zjarr.

MUSLIMI |

**Hadithi - 252:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Umreja në ramazan është e barabartë me Haxhillëkun tim, apo sikur të kishte agjëruar me mua.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 253:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Të kalosh një pjesë të ditës apo një ditë të plotë në rrugë të Allahut, është më e vlefshme se e tërë bota dhe çka ka në të.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 254:**

*Transmetohet nga Sehl bin Sead r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:*

Ribati (ndërlidhmëria) në rrugë të Allahut është më e vlefshme se bota dhe gjithçka ka në të,

Një vend në xhenet është më i vlefshëm se bota dhe gjithçka që ka në të.

Shkuarja apo kthimi prej luftës në rrugë të Allahut është me e vlefshme se bota dhe gjithçka që ka në të.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 255:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdo plagë prej plagëve të Luftëtarit në rrugë të All-llahut vjen në ditën e Kijametit duke pikuar gjak dhe ngjyra e asaj plage ngjyrë e kuqe dhe ngjyrë gjaku, ndërsa era e asaj plage erë misku.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 256:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në xhenet janë njëqind nivele, të cilat i ka përgatitur Zoti vetëm për muxhahidët; distanca mes niveleve është sa distanca në mes tokës dhe qiellit.

BUHARIU |

**Hadithi - 257:**

*Transmetohet nga Zejd Ibn Halidi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush përgatit luftëtarin në emër të Zotit, ai ka luftuar dhe kush e përcjell, e përshëndet dhe kujdeset për familjen e tij, ai ka luftuar në rrugën e All-llahut.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 258:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Amr bin Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti ia fal dëshmorit të gjitha gabimet, përpos borxhit.

MUSLIMI |

**Hadithi - 259:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e kërkon dëshmorinë me emër të plotë, Zoti do ta bëjë dëshmor, edhe nëse nuk vdes në front.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 260:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush kërkon me zemër dëshmorinë, Zoti i jep dëshmorinë, edhe pse nuk bie dëshmor.

BUHARIU |

### **Hadithi - 261:**

Transmeton Ebi Mes'udi r.a. se një njeri i vjen të Dërguarit s.a.v.s. me deve dhe i thotë: Kjo deve është në shërbim të luftës për në rrugën e All-llahut.

Muhamedi a.s. thotë: Në ditën e kijametit do t'i kesh shtatëqind deve.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 262:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos e dëshironi takimin me armikun, por kërkon fuqi dhe shëndet prej All-llahut, e kur të takoheni me armikun, bëhuni durimtarë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 263:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shehidët janë pesë llojesh:

- Ai që vdes nga Tauna (Kolera, sëmundje ngjitëse),
- nga metbuni (sëmundje e rëndë e barkut),
- ai që vdes nga përmytja në ujë,
- ai i cili vdes nga plasaritja nën gërmadha dhe
- Dëshmori në rrugën e Zotit.



**Hadithi - 264:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se ka shkuar një njeri te Muhamedi a.s. dhe e ka pyetur:*

O i Dërguari i All-llahut, nëse vjen dikush dhe kërkon dhe dëshiron pasurinë time:

- Mos ia jep pasurinë tënde.

Po nëse më lufton? - Mbroje pasurinë dhe luftoje atë.

Po nëse më vret? - Ju jeni shehid (dëshmorë).

Po nëse e vras atë? - Ai do të jetë në zjarr i djegur.

MUSLIMI

**Hadithi - 265:**

*Transmeton Ebu Hurejre se atij i ka thënë Muhamedi a.s.:*

Kush e liron një rob musliman, ai do ta kursej për çdo pjesë të trupit të atij robi çdo pjesë të trupit të tij nga djegia në xhehenem.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 266:**

*Transmetohet nga Muadal r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Adhurimi për All-llahun në kohën e trazirave, tragjedive dhe fatkeqësive është sikurse migrimi im.

MUSLIMI

**Hadithi - 267:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

All-llahu e mëshiroftë tolerantin kur shet e kur blen, por edhe kur i kanë borxh.

**Hadithi - 268:**

*Transmeton Katade r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush dëshiron që ta shpëtojë All-llahu prej vështirësive në ditën e Kijametit, le t'i ndihmojë atij i cili është në vështirësi dhe le t'ia largojë vështirësitë e tij.

MUSLIMI

**Hadithi - 269:**

*Transmetohet nga Muavija r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kujt ia do Zoti të mirën, i jep dituri në fenë e tij.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 270:**

*Transmetohet nga Sehl Ibn Sead r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Për Zotin, kur Zoti e udhëzon një njeri në rrugë të drejtë, është më e vlefshme se çdo pasuri tjetër.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 271:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr Ibn Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Transmetoni nga unë, po në qoftë se është në pyetje një ajet, tregoni nga beni Israilët se nuk prish punë; kush rren me qëllim për mua, le ta përgatitë vendin e tij prej zjarri.

BUHARIU

**Hadithi - 272:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e merr rrugën për të fituar dituri, Zoti do t'ia lehtësojë rrugën për në xhenet.

MUSLIMI |

**Hadithi - 273:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të vdes i biri Adem, i ndërpritet vlera e të gjitha veprave, përpos tri gjërave:

- lëmoshën rrjedhëse,
- diturinë për ta shfrytëzuar dhe për të përfituar pas tij,
- djalin e mirë, i cili lutet për të.

MUSLIMI |

**Hadithi - 274:**

*Transmetohet nga Abdullah ibn Amr Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Padyshim se All-llahu nuk e tërheq (humb) diturinë prej njerëzve përnjëherë, por e tërheq, duke i tërhequr dijetarët, deri sa nuk mbetet asnjë dijetarë për ta emëruar njerëzit; atëherë njerëzit emërojnë udhëheqës injorantët, e kur i pyesin, ata përgjigjen pa dituri, ashtu që udhëheqësit e humbin vetveten dhe njerëzit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 275:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush më dërgon mua salavatë një herë, Zoti i ndihmon atij për atë salavatë dhjetë herë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 276:**

*Transmetohet nga Ebi Malik Eshariu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Pastërtia është pjesë e besimit.

Falënderimi ndaj Zotit plotëson peshën me përpikëri,

Subhanellahi dhe Elhamdulilahi e mbushin çka ka prej qiejve e deri në tokë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 277:**

Transmetohet nga Sead Ibn Vekasi r.a. se një beduin e ka pyetur Muhamedi a.s.: Më mëso një fjalë?:

(Muhamedi a.s.) Është përgjigjur:

KUL LA ILAHE ILALLAHU VEHDEHU LE SHERIKE LEH,  
VALLAHU EKBER KEBIRA VELHAMDULLILAH KETHIRA,  
VE SUBHANELLAH RABIL ALEMIJN, VE LA HAVLE VE LA  
KUVETE ILA BILAHIL AZIZIL HAKIM.

Beduini tha: Këta janë për Zotin tim, por për mua. I Dërguari i tha:

KULILAHUME EGFIRLIJ VERHAMNIJ VEHDINIJ  
VERZUKNIJ.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 278:**

*Transmetohet nga Mugire Ibn Sheab r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

LA ILAHE ILALLAHU VEHDEHU LA SHERIJE LEH.  
LEHUL MULKU VE LEHUL HAMDU VE HUVE ALA KULI  
SHEJIN KADIJR.

O Zoti im, nuk ka pengesë për atë që Ti jep dhe nuk ka të dhënë për atë që Ti e pengon dhe nuk mund të bëjë dobi përveç Teje askush.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 279:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s.:*

Kur e përfundonte namazin thoshte:

LA ILAHE IL-LALLAHU VEHDEHU LA SHERIJKE LEHUL  
MULKU VE LEHUL HAMDU VE HUVE ALA KULI SHEJIN  
KADIR

ndërsa pas kësaj ka thënë:

33 herë SUBHANELLAH

33 herë ELHAMDULILAH

33 herë ALL-LLAHU EKBER.

(Kush i thotë këto) Zoti ia falë gabimet edhe nëse kanë qenë sa shkuma e detit.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 280:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur dikush thotë shehadetin, le të kërkoj mbrojtje prej katër gjërave.

E për ato gjëra thuaj:

O Zoti im! Kërkoj mbrojtje prej teje nga dënimi i xhehenemit,

- nga dënimi i varrit,

- nga sprovimimi i jetes dhe i vdekjes, dhe

- nga e keqja e mesihut-dexhall.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 281:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s.:*

SUBHANEKE ALLAHUME RABENA VE BIHAMDIKE  
ALLAHUMEGFIRLI

këtë e thoshte shpesh në ruku dhe në sexhde.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 282:**

*Transmetohet nga Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në ruku madhërojeni All-llahun duke thënë SUBHANE RABIJEL ADHIJME. Poashtu, në ruku angazhohuni dhe lutuni se All-llahu do t'i përgjigjet lutjes suaj.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 283:**

Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. e përkujtonte All-llahun pandërprerë në çdo moment.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 284:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. kur shtrihej thoshte:*

Falënderimi i takon Zotit, i cili na ka ushqyer, na ka furnizuar me pije dhe na ka bërë vend për strehim e pushim, sepse ka të atillë të cilët nuk kanë vendstrehim.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 285:**

*Transmetohet nga Abdullah ibn Amr Ibn Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

O Zoti im! Ti je shndërrues i zemrave, shndërroj zemrat në adhurimin Tënd.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 286:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kërkoni mbrojtje nga All-llahu:

- nga të këqijat e sprovimeve,
- nga mosdëgjueshmëria,
- nga fatkeqësia,
- nga ofendimet dhe
- lajkat e armiqve.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 287:**

*Transmetohet nga Ebi Dardai r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Duaja e muslimanit për vëllain e tij, i cili nuk është prezent pranohet; në kokë të tij qëndron meleku dhe çdo moment kur të bëjë dua për vëllain, meleku thotë: Amin edhe juve po ashtu.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 288:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush beson në All-llahun dhe në botën tjetër, le të thotë fjalë të mirë, ose në të kundërtën le të heshtë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 289:**

Transmetohet nga Ebi Musa r.a. se e ka pyetur Muhamedi a.s: Cili është muslimani më i miri?

Muhamedi a.s është përgjigjur: Ai prej të cilit janë të qetë muslimanët, nga gjuha dhe dora e tij

**Hadithi - 290:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Neriu flet pa dije, ndërsa nuk e di se ajo fjalë e hedh në zjarr në distancë, sa është largësia e lindjes prej perëndimit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 291:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtet robi kur flet fjalë në kënaqësinë e All-llahut, All-llahu e ngrit në shkallë të larta.

Ndërsa, kur robi flet fjalë në hidhërimin e All-llahut, fjalët do ta hedhin në xhehenem pronarin e tyre.

BUHARIU |

**Hadithi - 292:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

E dini çka është përgojimi?

Iu përgjigjëm: All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.

I Dërguari tha: Të thuash për vëllain atë çka e urren ai.



Njëri prej es'habëve tha: Po nëse është e vërtetë te vëllai atë çka e them?

Nëse është e vërtetë ajo çka e thua për të, e ke përgjohuar, e nëse nuk është e vërtetë ajo çka e thua për të, i ke bërë shpifje - u përgjigj Muhamedi a.s.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 293:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdo gjë e muslimanit për muslimanin është e ndaluar:

- gjaku i tij,
- nderi i tij dhe
- pasuria e tij.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 294:**

*Transmetohet nga Hudhejfe r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Bartësi i fjalëve nuk hyn në xhenet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 295:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Drejtësia të shpie në bamirësi, bamirësia të shpie në xhenet. Deri sa njeriu e flet të vërtetën, ai është i shënuar te All-llahu prej të drejtëve.

Rrena të shpie në mëkate, mëkatet të shpijnë në xhehenem. Deri sa njeriu rren, ai është i shënuar te All-llahu prej rrenacakëve.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 296:**

*Transmetohet nga ibn Abasi r.a se Muhamedi a.s ka thënë:*

Kush tregon diçka çka nuk e ka parë, do të ngarkohet me atë barrë e cila nuk ka ndodhur.

Kush dëgjon ndonjë ngjarje nga ndonjë shoqëri, të cilët nuk e dëshirojnë të përhapet, ajo ngjarje do t'i hidhet në vesh në ditën e kijametit.

Kush pikturon pikturë, do të ndëshkohet dhe do të ngarkohet në atë mënyrë që do t'i kërkohet që asaj pikturë t'i japë shpirt, por ai nuk do të ketë mundësi ta bëjë.

BUHARIU |

### **Hadithi - 297:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Prej çështjeve më të këqija është kur njeriu tregon një çështje (një ngjarje) të cilën nuk e ka parë, e thotë se e ka parë.

BUHARIU |

### **Hadithi - 298:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e tregon për mua një thënie dhe e di se ajo është rrenë, ai është rrenacak.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 299:**

*Transmetohet nga Ebi Dardai r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në ditën e Kijametit nuk do të ketë ndërmjetësim (shefaat) për ata të cilët mallkojnë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 300:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk lejohet të shoqërohesh me atë, i cili mallkon.

MUSLIMI

**Hadithi - 301:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush shpif për robëreshën se është prostitutë, ai do të dënohet në ditën e gjykimit, (do të shpëtojë) vetëm nëse është e vërtetë ashtu si ka thënë.

MUTEFIKUN ALEJHI

**Hadithi - 302:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos i shani të vdekurit, sepse ata e kanë arritur atë çka kanë vepruar.

BUHARIU

**Hadithi - 303:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Amr bin Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush dëshiron të shpëtojë nga Zjarri dhe të hyjë në xhenet, le të ketë shpresën dhe besimin në All-llahun, le të ketë shpresën dhe besimin dhe në ditën e ringjalljes dhe le t'u flasë njerëzve çka është mirë t'u flitet atyre.

MUSLIMI

**Hadithi - 304:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Amr bin Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Musliman është ai prej të cilëve janë të qetë (të shpëtuar) muslimanët, nga dora dhe gjuha e tij.

Muhaxhir është ai i cili është larguar nga ajo çka e ka ndaluar All-llahu.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 305:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos urreni,

mos bëni zili,

mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit,

mos i ndërpritni marrëdhëniet,

por bëhuni rob të All-llahut dhe vëllezër për hir të Tij. Nuk lejohet që muslimani të largohet (hidhërohet) prej vëllait të tij më shumë se tri ditë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 306:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Dyert e xhenetit hapen të hënën dhe të enjten dhe i falen gabimet çdo robi i cili nuk i ka bërë shok All-llahut, përpos njeriut i cili ka qenë në armiqësi me vëllain dhe i thuhet: Pritni për këta dy deri sa të pajtohen, pritni për këta dy deri sa të pajtohen.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 307:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos paramendoni keq, sepse paramendimi i keq është rrenë e vërtetë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 308:**

*Transmetohet nga Xhendebi bin Abdullahu r.a. se Muhamedi a.s. në ditë e shpjegonte një çështje duke thënë:*

Një njeri ka thënë se All-llahu nuk do t'ia falë gabimet filanit, ndërsa All-llahu i Lartmadhëruar i është përgjigj atij: Kush përbetohet në Mua se nuk do t'ia fali gabimet filanit, atëherë unë do t'ia fali gabimet filanit, ndërsa ty veprat e tua do t'i ngarkoj me mëkate.

MUSLIMI

### **Hadithi - 309:**

*Transmetohet nga Ebi Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdo njeri i cili ka premtuar dhe e ka thyer premtimin, në ditën e Kijametit do ta ketë një shenjë dalluese në trup dhe do të njoftohet: Ky është ai i cili ka premtuar dhe ka tradhtuar.

MUTEFIKUN ALEJHI

### **Hadithi - 310:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre ra..a se Muhamedi a.s. ka thënë:*

All-llahu i Lartmadhëruar ka thënë: Në ditën e Kijametit do të jem kundërshtar i tre personave:

- Atij të cilit i kam dhënë dhe më ka tradhtuar.
- Njeriut, i cili ka shitur njeriun e lirë dhe i ka shpenzuar ato të holla.
- Njeriut, i cili ka marrë diçka me qira, i ka skaduar afati dhe nuk e paguan qiranë.

BUHARIU

### **Hadithi - 311:**

*Transmetohet nga Ebi Ejubi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk lejohet që muslimanin të largohet (hidhërohet) prej vëllait të tij më shumë se tri ditë. Kur të takohen ata dy, duhet që secili prej tyre t'i ofrojë pajtim njëri-tjetrit; më i miri është ai i cili fillon i pari me selam (i ofron pajtim).

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 312:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të jeni tre, deri sa të përzihen njerëzit, mos pëshpëritni ju dy e ta lini anash të tretin, se kjo e pikëllon atë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 313:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ai i cili e kthen dhuratën, i ngjan qenit i cili e kthen pështymën tij.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 314:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Largohuni prej shtatë mëkateve të mëdha:

Të pranishmit e pyetën: Cilat janë ato o i Dërguari i Zotit?

I Dërguari u përgjigj:

- T'i bësh shok All-llahut,

- magjia,

- vrasja e njeriut të cilin e ka ndaluar All-llahu, vetëm nëse është në pyetje me të drejtë,

- kamata,

- shfrytëzimi i pasurisë së jetimit,

- ikja nga fronti dhe

- shpifja për gratë e ndershme dhe të pafajshme.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 315:**

Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se i Dërguari a.s. e ka mallkuar atë i cili ha kamatën dhe i cili ndërmjetëson në të.

MUSLIMI

### **Hadithi - 316:**

*Transmetohet nga Ebu Hurjer r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në ditën e Kijametit prej njerëzve të parë të cilët do të gjykohen janë:

Dëshmori, i cili do të paraqitet me veprën e dëshmorisë së tij, iu paraqiten të mirat e dëshmorisë dhe i kupton.

Zoti e pyet: Pse ke rënë dëshmor?

Përgjigjet: Për Ty kam luftuar deri sa rashë dëshmorë.

Zoti i thotë: Po rren, sepse e vërteta është se ti ke luftuar që të thuhet për ty se ke luftuar, e kjo është thënë për ty.

Pastaj urdhërohen Melekët që të kapet për fytyrë deri sa të hidhet në zjarr.

Pastaj, njeriu i cili ka përfituar dituri, ka mësuar të tjerët, ka lexuar Kur'an, edhe këtij i paraqiten të mirat dhe shpërblimet e ditorisë dhe i kupton.

Pastaj pyetet: Pse ke arritur këtë nivel?

Ai përgjigjet: Kam përfituar dituri, kam mësuar të tjerët dhe kam lexuar Kur'an për Ty.

Zoti i thotë: Po rren, sepse ti ke mësuar që të thuhet për ty se je dijetar e po lexon Kur'an, e kjo veç është thënë. Pastaj, urdhërohen Melekët që të kapet për fytyrë deri sa të hidhet në zjarr.

Pastaj, njeriu të cilit ia ka mundësuar Zoti që të ketë pasuri dhe ka shpenzuar, edhe këtij i paraqiten të mirat e dhënies dhe i kupton.

Pastaj pyetet: Pse ke shpërndarë pasuri?

Në çdo rrugë që ti ke urdhëruar dhe ke dashur që të jepet pasuri, unë kam dhënë vetëm për ty o Zot.

Zoti i thotë: Po rren, por ti ke dhënë pasuri që të lavdërohesh e je lavdëruar.

Pastaj, urdhërohen Melekët që të kapet për fytyrë deri sa të hidhet në zjarr.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 317:**

Transmetohet nga Ebu Dherri r.a. se është pyetur Muhamedi a.s. për njeriun, i cili punon një punë të mirë që ta lavdërojnë njerëzit për atë punë. Ndërsa Muhamedi a.s. u është përgjigjur: Ai e ka shpejtuar (humbur) shpërblimin për atë punë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 318:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Biri i Ademit ka bërë prostitucion, edhe pse nuk ka bërë marrëdhënie:

- Prostitucioni i syve është shikimi për prostitucion,
- prostitucioni i veshëve - dëgjimi për prostitucion,
- prostitucioni i gjuhës - të folurit për prostitucion,
- prostitucioni i duarve - prekja e prostitutës,
- prostitucioni i këmbëve - ecja për punë të prostitucionit,
- po ashtu, për zemrën që dëshiron, shpreson dhe kërkon marrëdhënie jashtë martesore është prostitucion.

MUTEFIKUN ALEJHI |



**Hadithi - 319:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Burri mos të shikojë në organet e turpshme të burrit.

Gruaja mos të shikojë në organet e turpshme të gruas.

Mos të flejnë dy burra të zhveshur nën një mbulesë.

Mos të flejnë dy gra të zhveshura nën një mbulesë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 320:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos të vetmohet askush prej jush me femër të huaj, pos nëse është kujdestari prej familjes së saj.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 321:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos ha me të majtën, sepse, në të vërtetë, shejtani ha dhe pi me të majtën.

MUSLIMI |

**Hadithi - 322:**

*Transmetohet nga Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Allahu e ka mallkuar lidhësen e flokëve edhe kërkuesen e lidhësëve të flokëve, atë që i heq vetullat dhe atë që kërkon t'i hiqen vetullat.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 323:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush bën një punë e cila nuk përkon me çështjet tona, nuk pranohet.

MUSLIMI |

**Hadithi - 324:**

*Transmetohet nga Umer Ibn Hatabi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

I vdekuri dënohet në varr, ndërsa tjerët vajtojnë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 325:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk është prej neve ai i cili rrah fytyrën, i shqyen rrobat dhe vepron si në kohën e injorancës.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 326:**

*Transmetohet nga Mugne bin Shuëbe r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. të thotë:*

Kush vajtohet, ai do të dënohet për atë vajtim në ditën e kijametit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 327:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se është pyetur Muhamedi a.s. për falltorët, ndërsa Muhamedi a.s. është përgjigjur:*

Nuk ka asgjë të vërtetë prej tyre. Pastaj i tregojnë të Dërguarit s.a.v.s. se ata ndonjëherë parashohin me fall çka del e vërtetë. Muhamedi a.s. u thotë: Kjo është vërtet fjalë e xhinit, i cili e vulos në veshin e bashkëvepruesve të tij dhe prej saj i shpikin njëqind rrena.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 328:**

*Transmetohet nga Safijete bint Ebi Sajid, e ajo nga disa gra të Muhamedit a.s. r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush shkon te falltori dhe e pyet për diçka e i beson atij, nuk i pranohet namazi katërdhjetë ditë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 329:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos flisni fjalë armiqësie e as fjalë të kota, por më së shumti më pëlqejnë fjalët e mira dhe të bukura.

MUTEFIKUN ALEHI |

### **Hadithi - 330:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ata të cilët ndërtojnë statuja, idhuj, do të dënohen në ditën e Kijametit dhe do t'u thuhet: Ja, ngjallni çka keni ndërtuar prej idhujve tuaj.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 331:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Në ditën e Kijametit më së shumti do të ndëshkohen ata të cilët kanë shpikur idhuj dhe kanë pikturuar idhuj.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 332:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

Nuk ka mëkat më të madh se ai, i cili mundohet të krijojë buburreca siç kam krijuar Unë, ose grurë siç kam krijuar Unë, ose elb siç kam krijuar Unë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 333:**

*Transmetohet nga Talha r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Në shtëpinë ku kanë qenë piktura e skulptura, Melekët nuk hyjnë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 334:**

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Xhibrili i ka premtuar Muhamedit a.s. se do të shkojë në shtëpinë e tij, mirëpo është vonuar dhe nuk ka shkuar atë ditë. Muhamedit a.s. i ka ardhur shumë vështirë dhe del nga shtëpia dhe i ankohet përse nuk kishte ardhur. Mirëpo, Xhibrili i thotë: Ne nuk hymë në shtëpinë ku ka qej dhe ikona (fotografi adhurimi).

MUSLIMI |

### **Hadithi - 335:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Kush përkujdeset për qen, përpos dresimit të qenve për gjuajtje apo për ruajtjen e bagëtisë, për çdo ditë atij do t'i pakësohet shpërblimi i dy kirateve.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 336:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se ka thënë Muhamedi a.s.:*

Aty ku ka qenë ose kumbana Melekët nuk rrinë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 337:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Pështyma në oborr të xhamisë është mëkat (gabim), ndërsa ajo çka është në oborr menjëherë duhet të mbulohet me dhe, ose të eliminohet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 338:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush dëgjon njeri duke thurrur, recituar, kënduar këngë ose duke kërkuar t'i këndojë në xhami, le t'i thotë atij: Xhamitë nuk janë për këto çështje, mos t'u plotësoftë dëshira.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 339:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush ka ngrënë hudhër ose qepë, le të largohet prej nesh, ose le të largohet prej xhamisë tonë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 340:**

*Transmetohet nga Ibn Amri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtet All-llahu ju ndalon të përbetoheni në prindërit tuaj; kush përbetohet, le të përbetohet në All-llahun, ose le të heshtë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 341:**

*Transmetohet nga Ebi Umame bin Thealebe Harithi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush ia merr të drejtën e muslimanit me përbetim të rrejshëm All-llahu ia ndalon xhenetin dhe ia obligon xhehenemin.

Një njeri e pyeti: Po edhe në qoftë se është në pyetje diçka me vlerë të lehtë?.

I Dërguari u përgjigj: Edhe nëse është me vlerë të paktë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 342:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr Ibn Asi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mëkatet e mëdha janë:

- T'i bësh shok All-llahut,
- të sillesh keq me prindërit,
- vrasja dhe
- përbetimi rrejshëm.

BUHARIU |

**Hadithi - 343:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Përbetimi sjell dobi prej sendit, por shkakton dëm në fitim (të përgjithshëm).

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 344:**

*Transmetohet nga Ebi Katade r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos e bëni traditë të përbetoheni shumë në shitblerje, se në fillim përfitoni, e pastaj e humbni fitimin.

MUSLIMI |

**Hadithi - 345:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Prej emrave (që përdoret tek njerëzit) më të papranuar dhe të këqij te All-llahu i Lartmadhëruar është emri Melikul Emlak - Sundues i sundimtarëve.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 346:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Zoti im, kërkoj të mirën e saj, të mirën prej asaj dhe të mirën pse e ke dërguar dhe,

mbështetem te Ti nga e keqja e saj, nga e keqja prej saj dhe nga e keqja për çka e ke dërguar.

MUSLIMI |

**Hadithi - 347:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Askush të mos thotë

HABUTHET NEFSI - më ka gjetur e keqja, por le të thotë

LEKASET NEFSI - jam në gjendje të vështirë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 348:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur t'i lutet dikush All-llahut, le të jetë i vendosur dhe le t'i lutet me singëritet e me shpresë, e mos të lutet i pashpresë duke thënë: Nëse do më jep.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 349:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A nuk frikësohet ndonjëri prej jush kur të ngre kokën para Imamit se Zoti do t'ia shndërrojë kokën në kokën e gomarit apo formën në formën e gomarit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 350:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nuk ka namaz para ushqimit dhe duke u shtrënguar nga kryerja e nevojës.

MUSLIMI |



### **Hadithi - 351:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çka ka një popull i cili falet, por kur të falen shikimet e tyre i ngritin lart.

Pastaj vazhdon Enesi duke treguar Muhamedi a.s se ka thënë.:

Le ta ndërpresin sa më shpejt atë veprim dhe le t'i ulin shikimet e tyre.

BUHARIU |

### **Hadithi - 352:**

*Transmetohet nga Ebi Murthid Kenaz bin el Husejn r.a. se ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Mos u falni në varre dhe mos u ulni mbi ta.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 353:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të jetë duke u falur farzi, mos të falet namaz tjetër, përpos atij farzi (nuk lejohet dy xhematë me falë farzin përnjëherë).

MUSLIMI |

### **Hadithi - 354:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Asnjëri prej jush mos të agjërojë ditën e xhumasë, pa e agjëruar një ditë para ditës së xhumasë, ose një ditë pas ditës së xhumasë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 355:**

Transmeton Nëna e besimtarëve Xhujejrije bint el Harith r.a. se në ditën e xhumasë derisa ajo agjëronte Muhamedi a.s. e ka pyetur: A ke agjëruar dje?.

Ndërsa ajo i është përgjigjur: Jo.

Pastaj e ka pyetur: A do të agjërosh nesër? (ka pasur për qëllim ditën e shtunë).

Prapë i është përgjigjur: Jo.

Muhamedi a.s. ka thënë: Mos agjëro as sot. (Me ditën e xhumasë agjërohet ose e enjtja, ose e shtuna).

BUHARIU |

### **Hadithi - 356:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Të ulet ndonjëri prej jush në gaca të zjarrit dhe t'u digjen rrobat e lëkura, është më mirë se sa të ulet mbi varre.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 357:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ruajuni nga dy mallkime.

E pyesin: Po cilat janë ato dy mallkime?

Muhamedi a.s. u përgjigj: Ai i cili kryen nevojë (urinë) në rrugën nëpër të cilën kalojnë njerëzit, ose nën hije.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 358:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Mos ta blejë asnjëri prej jush sendin, të cilin e ka blerë vëllai i tij dhe mos ta fejojë asnjëri prej jush të fejuarën, të cilin e ka fejuar vëllai i tij, vetëm nëse ai heq dorë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 359:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Asnjëri prej jush mos të shënjojë me armë, sepse nuk e di se shejtani ndoshta e shtyn dorën e tij dhe hyn në zjarr të xhehenemit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 360:**

*Transmeton Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Cilit i dhurohet era e rejhanit, le ta pranojë, se ajo ka erë të lehtë dhe të mirë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 361:**

Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. gjithmonë e pranonte erën e mirë dhe parfumosjen.

BUHARIU |

### **Hadithi - 362:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Vërtet, All-llahu nuk i shikon format tuaja, as trupin fizik tuajin, por shikon zemrat dhe veprat tuaja.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 363:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Sikur të kishte i biri i Ademit një kodër me ar, do të dëshironte t'i kishte dy kodra me ar. Nuk e mbush gojën e tij vetëm SE dheu dhe e fal Zoti pendimtarin.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 364:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

All-llahu xh.sh. u thotë melaqeve:

Kur të dëshirojë robi im të veprojë keq, mos ia shënoni deri sa ta veprojë.

Nëse e bën atë të keqe, shënojeni, e nëse nuk e vepron për hir Timin, shënojeni punë të mirë.

Nëse dëshiron të veprojë mirë dhe nuk e vepron, shënojeni, e nëse e vepron, shënojani dhjetë të mira deri në shtatëqind.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 365:**

*Transmetohet nga Enes bin Maliki r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush largohet nga suneti im nuk është prej meje.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 366:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush bën thirrje për në rrugë të drejtë, ai shpërblehet me shpërblimet e atij i cili e ka pasuar rrugën e drejtë dhe atij nuk i pakësohet asgjë prej shpërblimeve të tij.

Kush thërret në humbje, ai do t'i ketë mëkatet të cilat i ka bërë pasuesi i tij dhe nuk i pakësohet prej mëkateve të tij aspak.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 367:**

*Transmetohet nga Uthmani r.a. se kur Muhamedi a.s. e pa xhaminë e tij duke u ndërtuar, e kam dëgjuar duke thënë:*

Kush ndërton një xhami për hir të All-llahut, All-llahu do t'i ndërtojë Shtëpi në Xhenet.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 368:**

*Transmetohet nga Ibn Amri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Namazi me xhemat është më i vlefshëm se namazi vetëm për njëzetë e shtatë herë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 369:**

*Transmetohet nga Ibn Musa r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Shembulli i shtëpisë në të cilën përmendet emri i All-llahut dhe i shtëpisë në të cilën nuk përmendet emri i Tij, i ngjan shembullit të të gjallit me të vdekurin.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 370:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të përfundojë imami Fatihan duke thënë: GAJRIL MAGDUBI ALEJHIM VE LED-DALIIN thuaj AMIN, sepse nëse këtë e thonë edhe melaqet, atëherë të fshihen gabimet e mëparshme.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 371:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të këndojë i biri Ademit ajetin e sexhdes dhe bie në sexhde, shejtani largohet duke qarë dhe duke thënë: Mjerë për mua. U urdhërua i biri Ademit për sexhde dhe ra në sexhde, e atij i takon xheneti, ndërsa unë jam urdhëruar për sexhde dhe e kam refuzuar, për këtë do të dënohem me xhehenem.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 372:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush pastrohet në ditën e xhuma dhe shkon në xhami në orën e parë, e ka vlerën sikur të presë një deve kurban.

Nëse shkon në orën e dytë, e ka vlerën sikur të presë një lopë kurban.

Nëse shkon në orën e tretë, e ka vlerën sikur të presë një dele kurban.

Nëse shkon në orën e katërt, e ka vlerën sikur të presë një pulë kurban.

Nëse shkon në orën e pestë, e ka vlerën sikur të japë një vezë sadaka.

Nëse Imami fillon hutben, melekët e dëgjojnë hutben.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 373:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Një njeri u jepte borxh njerëzve, mirëpo kur u vinte afati i kthimit të borxhit, e dërgonte të autorizuarin (punëtorin e tij) dhe i thoshte: Shiko, kush e ka gjendjen e vështirë kurseje dhe kaloje, ndoshta Allahu do të na kursejë edhe në botën tjetër;

Zoti do ta kursejë dhe do ta kalojë (pa e ndëshkuar).

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 374:**

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Amr Ibn Asir r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Agjërimi nga tri ditë të çdo muaji është sikur të agjërosh gjithmonë.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 375:**

*Transmetohet nga Enes bin Maliki r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Ngrihuni dhe hani syfyr se në syfyr ka bekim të All-llahut.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 376:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
O Zot, fali ato që i ruajnë flokët (ka për qëllim gjatë haxhit).  
Të tjerët i thanë: Edhe ata të cilët i shkurtojnë flokët.  
Muhamedi a.s. tha: O Zot, fali ata që i ruajnë flokët.  
Të tjerët prapë i thanë: Edhe ata të cilët i shkurtojnë flokët.  
Muhamedi a.s. tha: O Zot, fali ata që i ruajnë flokët.  
Të tjerët prapë i thanë: Edhe ata të cilët i shkurtojnë flokët.  
Atëherë edhe Muhamedi a.s. tha: O Zot, fali edhe ata të cilët i shkurtojnë flokët.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 377:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Kush përkujdeset për vendstrehimin e banorëve të Medinës apo përkujdeset për shërimin e tyre, Unë do të jem dëshmitar dhe ndërmjetësues për të.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 378:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Zoti im, bekoje Medinën dyfish nga ajo që e ke bekuar Meken.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 379:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

O i Dërguar i Zotit, çka mund të barazohet me luftën në rrugën e Zotit?

I Dërguari ka thënë: Nuk mundeni.

E pyetën edhe dy apo tri herë dhe është përgjigjur: Nuk mundeni.

Në fund ka thënë: Shembulli i Muxhahidit në rrugën e Zotit i ngjan agjëruesit, i cili përpiqet t'i kryejë obligimet dhe vepron sipas ajeteve të Kur'anit e nuk bën dyfytirësi në namaz, as në agjërime, deri sa të kthehet Muxhahidi i rrugës së Zotit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 380:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Bereqeti është edhe në kuaj.

MUTEFIKUN ALEJHI |

**Hadithi - 381:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se ai e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Vdekja e çdo muslimani prej kolerës konsiderohet si vdekje e shehidit.

MUTEFIKUN ALEJHI |



### **Hadithi - 382:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se e ka pyetur Muhamedin a.s.:*

Kush do të jetë më fatlumi për ta përjetuar shefaatin tënd në ditën e gjykimit?.

Muhamedi a.s. iu përgjigj: E kam menduar se për këtë çështje askush tjetër nuk do të më pyes para teje, pasi që e kam hetuar interesimin tënd për shefaatin tim, por po të tregoj se:

Njeriu më fatlum për ta përjetuar shefaatin tim në ditën e kijametit do të jetë ai, i cili me zemër të pastër dhe me fjalë të sqartë thotë: LA ILAHE IL-LALLAH (Nuk ka Zot tjetër përpos All-llahut).

BUHARIU |

### **Hadithi - 383:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Do të vijë një kohë kur njerëzit nuk do të mërzen se a e fitojnë pasurinë hallall apo haram.

BUHARIU |

### **Hadithi - 384:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush lufton kundër nesh, nuk është prej nesh, dhe kush na tradhton, nuk është prej nesh.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 385:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush huazon për të larë borxhin, Zoti do t'i ndihmojë për ta larë atë borxh.

Kush huazon vetëm për ta shkapërderdhur atë pasuri, Zoti nuk do t'ia mundësojë për ta larë atë borxh.

BUHARIU |

### **Hadithi - 386:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

O ju djem të rinj, kush prej jush ka mundësi materiale dhe aftësi trupore, le të martohet, sepse martesë është mbrojtje e syrit dhe mbrojtje e epshit.

Kush nuk ka mundësi, le të agjërojë, sepse agjërimi e pengon prej imoralitetit.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 387:**

*Transmetohet nga Sead bin Vekasi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush thotë se nuk jam i babait tim, por i tjetërkujt, ndërsa ai e di se është i babait të tij, xheneti për të është i ndaluar.

MUTEFIKUN ALEJHI |

### **Hadithi - 388:**

*Transmetohet nga Xhabiri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtet Iblisi e shtron frontin e tij në ujë dhe i dërgon ushtarët (shejtanët) për të bërë çrregullime dhe më i ulëti i tij bën çrregullime të mëdha.

Pasi të kthehen ushtarët e tij, i pyet: Çka keni bërë?

Njëri prej tyre thotë: Kam bërë këtë, kam bërë atë, Iblisi thotë: Nuk ke bërë asgjë.

Tjetri thotë: I kam ndarë dy bashkëshortë të martuar.

Iblisi i thotë: Po (mirë), afrohu, dhe e afron afër vetes.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 389:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Prostituti nuk bën prostitucion deri sa ai të jetë besimtar.

Hajni nuk vjedh deri sa ai të jetë besimtar.

Alkoolisti nuk pi alkool deri sa ai të jetë besimtar.

BUHARIU DHE MUSLIMI |

### **Hadithi - 390:**

*Transmetohet nga Ibn Mes'udi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Është e ndaluar vrasja e muslimanit deri sa ai të thotë LA ILAHE ILLALLAH MUHAMEDUN RESULULLAH. Përpos në tre raste:

- Ekzekutimi i të martuarit prostitut,
- vrasësin me qëllim (ekzekutimi i tij) dhe
- tradhtarin e fesë (murtedin), i cili e ndan xhematin.

BUHARIU DHE MUSLIMI

### **Hadithi - 391:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ai i cili është musliman i vërtetë prej jush dhe bënë punë të mira, për çdo të mirë i shkruhen dhjetë të mira e deri në shtatëqind të mira dhe për çdo të keqe i shkruhet vetëm një e keqe.

BUHARIU

### **Hadithi - 392:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Do të dalë nga xhehenemi kush thotë LA ILAHE IL-LALLAH, ndërsa në zemrën e tij ka sa kokrra e elbit mirësi.

Do të dalë nga xhehenemi kush thotë LA ILAHE IL-LALLAH, ndërsa në zemrën e tij ka sa kokrra e drithit mirësi.

Do të dalë nga xhehenemi kush thotë LA ILAHE IL-LALLAH, ndërsa në zemrën e tij ka sa grimca e atomit mirësi.

BUHARIU

### **Hadithi - 393:**

*Transmetohet nga Selmete bin Ekvea r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Kush thotë për mua diçka çka nuk kam thënë, le të përgatitë ulësen e tij prej zjarrit në xhehenem.

BUHARIU

**Hadithi - 394:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush harron dhe nuk e ka falur ndonjë namaz, le ta falë kur t'i kujtohet se nuk e ka falur (KAZA), sepse për namazin nuk ka kurrfarë kompensimi. (Fale namazin për të më përkujtuar).

BUHARIU |

**Hadithi - 395:**

*Transmetohet nga Uthmani r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush vdes me bindje se nuk ka Zot tjetër përpos All-llahut, do të hyjë në xhenet.

MUSLIMI |

**Hadithi - 396:**

*Transmetohet nga Adi bin Samed se e ka dëgjuar Berai r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë për ensarët:*

Ata i duan besimtarët e singertë, i urrejnë munafikët.

Kush i do ata, i do All-llahu,

Kush i urren ata, i urren All-llahu.

MUSLIMI |

**Hadithi - 397:**

*Transmetohet nga Xhabir bin Abdullah r.a. se i ka ardhur një njeri Muhamedit a.s. dhe e ka pyetur:*

Cilat janë dy çështje parësore (Mevxhibat) dhe të domosdoshme?

Muhamedi a.s. i thotë:

Kush vdes e nuk i ka bërë shok Allahut, hyn në xhenet, ndërsa:

Kush vdes e i ka bërë shok All-llahut, hyn në xhehenem.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 398:**

*Transmetohet nga Enes bin Maliku r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*  
Vërtet All-llahu nuk bën padrejtësi:

- Besimtarit i jep të mira në këtë dynja, por për çdo fatkeqësi e shpërblen në botën tjetër, ndërsa
- pabesimtarit i jep të mira në këtë dynja, saqë i shpenzon të gjitha dhe nuk i mbetet asgjë për në botën tjetër.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 399:**

Transmetohet nga Urvete bin Zubejri r.a. se Hakim bin Hazami e ka lajmëruar Muhamedin a.s. se në kohën e injorancës së tij ka dhënë sadaka, ka liruar robër, ka ndihmuar në përforsimin e marrëdhënieve farefisnore dhe e ka pyetur se a do të ketë shpërblim për të?.

Muhamedi a.s. i thotë:

Shpërblimi yt është se e ke pranuar Islamin, për shkak të atyre të mirave që i ke bërë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 400:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Islami u shfaq me shpejtësi të madhe dhe pa pritur e pa kujtuar, befasisht, dhe prapë do të përhapet me shpejtësi të madhe pa pritur e pa kujtuar, befasisht, dhe do të bashkohen muslimanët në mes të dy xhamive sikurse bashkohen gjarpërinjtë në birucën e tyre.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 401:**

*Transmeton Abdullah bin Katade nga baba i tij se Muhamedi a.s. ka thënë:*

- Kur të urinoni, mos e prekni organin me dorë të djathtë,
- mos pastroni ndyrësirën e nevojës me të djathtën dhe
- mos fryni në enë.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 402:**

*Transmetohet nga Ebu Hurerje r.a. se i ka thënë Muhamedi a.s.:*

Kur të pastrohet dikush nga ju (me gurë) prej nevojës së madhe, le të pastrohet tek, ndërsa kur ndonjëri prej jush merr abdes, le ta pastrojë hundën e tij me ujë dhe le ta heqë ujin (nga hunda).

MUSLIMI

#### **Hadithi - 403:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur muslimani apo besimtari e lan fytyrën e tij, i largohen nga fytyra e tij të gjitha gabimet e tij, të cilat i ka bërë me sytë e tij, e kjo menjëherë pas prekjes së ujit në fytyrë apo pas prekjes së pikave të ujit në fytyrë.

Kur t'i lajë duart, i largohen të gjitha gabimet që i ka bërë me duart e tij me largimin e ujit ose me largimin e pikës së fundit të ujit.

Kur t'i lajë këmbët e tij, i largohen të gjitha gabimet (mëkatet) që i ka bërë me këmbët e tij me largimin e ujit apo me largimin e pikës së fundit të ujit, derisa të pastrohet plotësisht prej gabimeve.

MUSLIMI

#### **Hadithi - 404:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur të zgjohet ndokush prej jush, le të fryjë hundën e tij tri herë, sepse shejtani ka qëndruar në hundën e tij deri sa ka qenë fjetur.

MUSLIMI

#### **Hadithi - 405:**

*Transmetohet nga Uthmani r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Kush merr abdes për namaz dhe e plotëson atë, pastaj shkon dhe i fal namazet farze së bashku me xhemat apo në xhami, All-llahu ia fal gabimet atij.

MUSLIMI

**Hadithi - 406:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se:*

Kur Muhamedi a.s. dëshironte të hante apo dëshironte të flinte, merrte abdes ngjashëm me abdesin e namazit.

MUSLIMI |

**Hadithi - 407:**

*Transmetohet nga Ebi Said Hudriu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kur ndonjëri prej jush kontakton seksualisht me bashkëshorten dhe dëshiron ta përsëritë, le të marrë abdes.

MUSLIMI |

**Hadithi - 408:**

*Transmetohet nga Ebi Basreti el Gafari r.a. se Muhamedi a.s. ua ka fal namazin e ikindisë dhe ka thënë:*

Ky namaz u është bërë obligim popujve para juve, mirëpo ata e kanë humbur (dhe nuk i kanë kushtuar rëndësi). Kush kujdeset për këtë namaz dhe e fal, ka shpërblim të dyfishtë dhe nuk ka namaz deri sa të paraqiten yjet.

MUSLIMI |

**Hadithi - 409:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ai i cili nuk e fal namazin e ikindisë, është sikur të humbë familjen dhe pasurinë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 410:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush e arrin një rekat (me xhemat), ai e ka arritur (shpërblimin) namazin me xhemat.

MUSLIMI |

**Hadithi - 411:**

*Transmetohet nga Ebi Hurerje r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sikur ta dinin njerëzit vlerën e ezanit dhe vlerën e safit të parë, për safin e parë do të hidhnin short nëse nuk ka vend.

Sikur ta dinin vlerën e (shkuarjes në xhami sa më herët) namazit, do të garonin për të shkuar sa më parë dhe sikur ta dinin vlerën e jacisë dhe sabahut, do të shkonin duke u zvarritur.

MUSLIMI |

**Hadithi - 412:**

Transmetohet nga Enesi r.a. se është falë me Muhamedin a.s., me Ebu Bekrin, me Umerin dhe me Uthmanin dhe nuk e ka dëgjuar duke e kënduar BISMILAHİ RRAHMANİ RRAHİM me zë (por në heshtje).

MUSLIMI |

**Hadithi - 413:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Sexhden bëje me përpikëri dhe asnjëri prej jush (në sexhde) mos t'i shtrijë krahët për tokë, ashtu siç i shtrin qeni këmbët për tokë.

MUSLIMI |



#### **Hadithi - 414:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Namazi me xhemat është më i vlefshëm se namazi vetëm për njëzet e pesë shpërblime.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 415:**

*Transmetohet nga Ebi Dardai r.a. se Muhamedi a.s. është falur dhe e kemi dëgjuar duke thënë:*

Kërkoj mbrojtje nga All-llahu prej teje. Pastaj ka thënë për së dyti: Qofsh i mallkuar me Mallkimin e Allahut tri herë dhe e ka zgjatur dorën e tij sikur të merrte diçka.

Pasi e ka përfunduar namazin, i thamë: O i Dërguar i All-llahut, të dëgjuam në namaz duke thënë diçka, që nuk të kemi dëgjuar më parë, dhe të pamë duke e shtrirë dorën?.

Muhamedi a.s. u përgjigj: Armiku i All-llahut, Iblisi, erdhi me një copë gacë të zjarrtë për ta hedhur në fytyrën time dhe i thashë: Kërkoj mbrojtje te All-llahu prej teje tri herë. Pastaj i thashë: Të mallkoftë All-llahu me mallkim të plotë dhe nuk u largua pas tri herëve; pastaj desha që ta kap dhe ta lidh, por, për Zotin, po të mos ishte duaja e vëllait tonë Sulejmanit (a.s.), do të kishte mbetur i lidhur dhe do të luanin me të fëmijët e qytetit në Medine.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 416:**

Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka parë një pështymë para xhamisë dhe është kthyer para njerëzve dhe i ka pyetur: Ç'është me ju, qëndroni para Zotit tuaj dhe pështyni para Tij?! A do të kishte dashur ndokush nga ju që të jetë i pështyrë në fytyrë?! Nëse ndokush pështyn, le të pështyjë në anën e majtë të tij dhe nën këmbët e tij. E nëse nuk mundet ashtu, atëherë le të marrë rrobën e tij dhe le ta fshijë.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 417:**

*Transmetohet nga Ebi Saidi Hudriju r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nëse ndokush prej jush, gjatë namazit, dyshon në atë se a i ka falur tri rekate apo katër, atëherë le ta vendosë në peshojë dyshimin dhe të vlerësojë në atë çka është më e sigurt, e pastaj le t'i bëjë dy sexhde shtesë (sehvi), para se të japë selam; nëse i ka falur pesë, janë plotësuar gjashtë, ndërsa nëse i ka falur katër, dy sexhde do të jenë hidhërim për shejtanin.

MUSLIMI

### **Hadithi - 418:**

Transmetohet nga Ibn Umer r.a. se Kur Muhamedi a.s. e këndonte Kur'anin dhe arrinte te ajeti i sexhdes, ai bënte sexhde, por edhe në bënim sexhde me të, deri sa në shumë raste nuk kishim vend ku të vendosnim ballin prej turmës së madhe.

MUSLIMI

### **Hadithi - 419:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se ka thënë:*

I kam falur me të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. para dreke dy rekate, pas dreke dy rekate, pas akshamit dy rekate, pas jaciesë dy rekate dhe pas namazit të xhumasë dy rekate, ndërsa akshamin, jacinë dhe sunetin e xhumasë e kam falur me të Dërguarin s.a.v.s. në shtëpinë e tij.

MUSLIMI

### **Hadithi - 420:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se:*

Zoti i Madhëruar, nëpërmjet të Dërguarit s.a.v.s., e ka bërë obligim që:

- vendasi t'i falë nga katër rekate
- udhëtari t'i shkurtojë në dy rekate, ndërsa
- në luftë dhe për shkak të frikës, të falet nga një rekat.

MUSLIMI

**Hadithi - 421:**

*Transmetohet nga Ebi Katade bin Rebii r.a. se Muhamedi a.s. ka kaluar pranë një Xhenaze dhe ka thënë:*

Ose është liruar, ose janë liruar prej tij.

I thanë: O i Dërguar i All-llahut çka është kjo: ose i liruar, ose janë liruar prej tij.

Ka thënë: Robi besimtar lirohet prej hiseve (problemeve të tjerëve) të kësaj bote, ndërsa prej robit kriminel lirohen (njerëzit, bimët, pemët dhe kafshët).

MUSLIMI |

**Hadithi - 422:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Umeri r.a. se:*

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e ka bërë obligim rekatin e fitrit të ramazanit për njerëzit: një saa prej hurmeve, ose një saa prej elbit për çdo të lirë, rob, mashkull ose femër prej muslimanëve.

MUSLIMI |

**Hadithi - 423:**

*Transmetohet nga bin Umeri r.a. se:*

Muhamedi a.s. ka urdhëruar të japin zekatin e fitrit para se të dalin njerëzit të falin namazin (e Bajramit) në Xhami.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 424:**

*Transmetohet nga Abdullah bin Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

O ju, gra muslimane, jepni sadaka vazhdimisht dhe shtojeni istigfarin, sepse kam parë se shumica prej jush janë banore të xhehenemit.

Njëra e cila ishte e mençur tha: Pse, o i Dërguar i All-llahut, jemi shumica prej banorëve të xhehenemit.

Muhamedi a.s. u përgjigj: Mallkoni shumë dhe jemi mosmirënjohëse ndaj kujdestarëve tuaj. Nuk kam parë më të dobët në logjikë dhe në fe se ju.

Gruaja prapë pyeti: Çka d.m.th. të dobët në logjikë dhe në fe?.

Muhamedi a.s. u përgjigj: Dobësia në logjikë është se: dëshmia e dy grave është e barabartë me dëshminë e një burri dhe dobësia në fe është se ju gjatë menstruacionit e plotësoni agjërimin (pasi që nuk agjëroni), ndërsa nuk e plotësoni namazin.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 425:**

*Transmetohet nga Ajshaj r.a. se një njeri ka shkuar te Muhamedi a.s. dhe i ka thënë:*

O i Dërguar i All-llahut, nëna ime ka vdekur befasisht dhe nuk ka lënë asnjë porosi (vasijet), mirëpo unë mendoj se po të kishte pasur mundësi të flasë, do të kishte porositur të japë sadaka. A ka ajo shpërblim, nëse jep sadaka për atë?. Muhamedi a.s. tha: Po.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 426:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdokush që jep sadaka, sado të jetë, edhe një hurme të cilën e ka fituar hallall, Zoti e pranon me dorën e djathtë dhe ia shton atij deri sa të bëhet sa kodra, apo më e madhe se kodra.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 427:**

*Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Kush nga ju është agjërueshëm sot?

Ebu Bekri thotë: Unë.

Kush ka falur namaz të xhenazës sot?

Ebu Bekri: Unë.

Kush ka ushqyer të varfër sot?

Ebu Bekri: Unë.

Kush ka vizitur të sëmurët sot?

Ebu Bekri: Unë.

Muhamedi a.s. thotë: tek ai që mblidhen këto virtyte, do të hyj në xhenet.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 428:**

*Transmeton Ebu Hurejre r.a se Muhamedi a.s ka thënë:*

Kush shpenzon për familjen e tij, ai ka shpenzuar në rrugë të Allahut dhe do të thirret për në xhenet për të mirën që ka bërë.

Kush do të jetë prej falësve të namazit, do të thirret nga dera e namazit.

Kush do të jetë prej luftëtarëve në rrugë të Allahut, do të thirret nga dera e rrugës së Allahut.

Kush do të jetë prej lëmoshdhënësve, do të thirret nga dera e lëmoshdhënësve.

Kush do të jetë prej agjëruesve, do të thirret nga dera e agjëruesve, e quajtur Rejjan.

Ebu Bekri Siddik r.a i thotë: A mundet që ndonjëri të ftohet nga të gjitha ato dyer?!

Muhamedi a.s. i thot: Po. Shpresoj se do të jesh i thirrur nga të gjitha ato dyer.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 429:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Çdonjëri është i krijuar prej 360 pjesëve (nyjeve). Kush e madhëron All-llahun, e falënderon All-llahun, e njëson All-llahun, e lavdëron All-llahun, kërkon falje prej All-llahut, ose largon gurin, ose ndonjë pengesë, ose ndonjë asht i cili i pengon njerëzit nga rruga, dhe urdhëron në punë të mira, ose largon nga rruga e keqe, do t'i numërohen atij sa janë 360 pjesët e trupit, të cilat kanë marrë pjesë për atë çështje dhe atëherë ai e ka shpëtuar veten e tij nga Zjarri i xhehenemit.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 430:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Nëse gruaja ushqehet nga ushqimi i shtëpisë së saj, pa keqpërdorim, ajo do të shpërblehet, po ashtu do të shpërblehet edhe burri i saj; po ashtu do të shpërblehet edhe kujdestari, mirëpo nuk do t'i pakësohet shpërblimi asnjërit prej tyre.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 431:**

*Transmetimi nga Enesi r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Njeriun e thinjë, e dobësojnë dhe e mplakin dy çështje:

- Lakmia për pasuri dhe
- lakmia për jetë sa më të gjatë.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 432:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se:*

Ka qenë së bashku me Sehabet dhe me Muhamedin a.s. në udhëtim. Gjatë udhëtimit disa agjëronin, disa të tjerë jo. Dhe u ndalëm në një vend për të pushuar, për shkak të nxehtësisë së madhe. Ata që agjëronin ishin të lodhur dhe hipën në deve, e vazhduan rrugën, ndërsa ata që nuk agjëronin, e vazhduan udhëtimin në këmbë, e Muhamedi a.s. tha: Ata që nuk agjëruan shkuan sot me shpërblime të mëdha.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 433:**

*Transmetohet nga Hamzete bin Amr Eslemiju r.a. se:*

E ka pyetur të Dërguarin:

A kam gabim nëse jam në udhëtim, mirëpo kam forcë dhe fuqi të agjërojë?.

Muhamedi a.s. ka thënë: Mosagjërimi është lehtësim, por kush vepron ashtu, ai vepron mirë; mirëpo edhe kush agjëron nuk ka gabim.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 434:**

*Transmetohet nga Ebi Dardai r.a. se. ka thënë:*

Në muajin ramazan kemi dalë me Muhamedin a.s. në vapë të madhe, saqë çdonjëri prej nesh e vendoste dorën në kokën e tij prej së nxehtit të fortë; prej neve ishin agjërueshëm vetëm dy: I Dërguari i All-llahut dhe Abdullah bin Revaha.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 435:**

*Transmetohet nga Abidullah bin Ebi Zejd se ka dëgjuar Ibn Abasin r.a. kur është pyetur për agjërimin e ditës së Ashurës duke thënë:*

Nuk kam dëgjuar për vlerën e ndonjë dite tjetër për agjërim, përpos kësaj dite dhe nuk kam dëgjuar për vlerën për agjërim, përpos këtij muaji të ramazanit.

MUSLIMI |

### **Hadithi - 436:**

*Transmetohet nga Nebishete el Hudhejli r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Ditët e Teshrikit janë ditë të ushqimit dhe të pijes. (në një transmetim tjetër)... edhe të përkujtimit të All-llahut.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 437:**

*Transmetohet nga Ebi Katade se është pyetur i Dërguari s.a.v.s. për agjërimin (nafilë) e ditës së hënë, e ai është përgjigjur:*

*Në atë ditë kam lindur dhe në atë ditë ka filluar Zbritja e Kur'anit.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 438:**

*Transmetohet nga Muadhete Adevije se e ka pyetur Ajshën r.a. për Muhamedin a.s.:*

*A ka agjëruar Muhamedi a.s. nga tri ditë të çdo muaji?*

*Ajo i është përgjigjur: Po.*

*Pastaj e ka pyetur: Cilat ditë të çdo muaji i ka agjëruar?*

*Ajo i është përgjigjur: Nuk e kam shikuar se cilat ditë të çdo muaji i ka agjëruar.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 439:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se:*

*Muhamedi a.s. e ka bërë iëtikafin (ka qëndruar në xhami) në dhjetë ditët e fundit të muajit ramazan, deri sa ka ndërruar jetë, pastaj, pas tij, kanë vepruar njësoj gratë e tij.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 440:**

*Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

*Kush vjen në këtë shtëpi (Qabe për ta kryer haxhin) e nuk bën gabime dhe nuk e prish haxhin me kontakt martesor, do të kthehet i pastër prej gabimeve, sikurse atë ditë kur e ka lindur nëna e tij.*

MUSLIMI |



#### **Hadithi - 441:**

*Transmetohet nga Ebi Seid el Hudriu r.a. se Muhamedi a.s ka thënë:*

Nuk lejohet për gruan, e cila beson në Zotin dhe në ditën e gjykimit të udhëtojë në një udhëtim, i cili zgjat tri ditë e më shumë, pa burrin e saj, ose pa prindin e saj, ose pa djalin e saj, ose pa vëllanë e saj, ose pa farefisin e saj.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 442:**

*Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se e ka dëgjuar të Dërguarin s.a.v.s. duke ligjëruar, e në mes të tjerash thoshte:*

Në haxh pantallonat i vesh ai, i cili nuk ka mbështjellës të madh për pjesën e poshtme, dhe mestet i vesh ai, i cili nuk ka nallane (papuqe).

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 443:**

*Transmeton Ebi Hurejrete r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Do të vijë një kohë për njerëzit, kur njeriu e thërret djalin e axhës ose të afërmin e tij e i thotë: “Ejani, ejani për të shpëtuar, Medina është vendi më i mirë për ju, sikur ta dinit.” Pasha Atë, që shpirti im është në dorën e tij, çdonjëri i cili del prej aty, Zoti do ta zëvendësoj një tjetër më të mirë se ai. Medineja është sikur vaji i cili e qet të keqen. Nuk ndodh dita e kijametit deri sa mos t’i heq Medineja të këqijtë që i ka në të, sikurse e heq vaji ndryshkun prej hekurit.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 444:**

*Transmetohet nga Xhabir bin Semrete r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Vërtetë All-llahu e ka quajtur Medinën Tabe.

MUSLIMI |

**Hadithi - 445:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se:*

Muhamedi a.s. e ka ndaluar kurorëzimin e quajtur shigar.

*Shigar quhet kur njeriu e marton bijën e tij për një djalë, me qëllim që babai i tij ta martojë bijën e tij për këtë njeri dhe vet ndërrimi të jetë në vend të mehrit (dhuratës martesore).*

MUSLIMI |

**Hadithi - 446:**

*Transmetohet nga Ebi Selmete bin Abdurrahmani se ka thënë:*

E kam pyetur Ajshën r.a. njëren prej grave të Muhamedit a.s. se sa ka qenë Mehri i të Dërguarit s.a.v.s. për gratë e tyre e ajo është përgjigjur:

Ka qenë mehri 12 Ukije dhe një Nesheë. Dhe pastaj ka pyetur: e di çka është Nesheë?. Pasi që Aisha ka thënë nuk e di, ka vazhduar duke thënë: gjysmë Ukije dhe kjo d.m.th. Mehri i të Dërguarit s.a.v.s. për gratë e tij ka qenë 500 dërm.

MUSLIMI |

**Hadithi - 447:**

*Transmeton Xhabir Ibnu Abdullahu r.a. se:*

I Dërguari i Allahut a.s. e ka parë një grua dhe menjëherë ka shkuar te bashkëshortja e tij dhe ka kontaktuar me të. Pastaj ka shkuar te sehabët e tij dhe u ka thënë:

Vërtet femra kur të vjen përpara, vjen mashtruese, sikur shejtani; kur të shkon mbrapa, të mashtron prapë si shejtani. Për këtë arsye, kur ndonjëri nga ju e sheh një grua, le të shkojë dhe le të kontaktojë me gruan e tij, sepse ashtu e largon dhe e mund epshin e tij.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 448:**

*Transmetohet nga Umi Atije r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Gruaja nuk lejohet të mbajë zi më shumë se tri ditë për të vdekurin; vetëm nëse është burri i saj, ajo mban zi 4 muaj e 10 ditë,

- Nuk vesh rrobë të parfumuar, por vetëm rrobë të rëndomtë.

- Nuk i rregullon vetullat, e as sytë me iktihal dhe nuk parfumohet, përpos nëse përdor aromë për të larguar aromën e keqe (nga menstruacioni).

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 449:**

*Transmeton Ebu Hurejrete r.a. se Sead bin Ibadete i ka thënë të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.:*

Po sikur ta gjeja gruan time me ndonjë burrë tjetër, a nuk duhet ta prek pa i gjetur 4 dëshmitarë? Po (i është përgjigjur).

Seadi i thotë: Kurrresi. Për Zotin, i cili të ka Dërguar me drejtësi, para se t'i gjej katër dëshmitar, do t'ia heq kokën.

I Dërguari i All-llahut tha: Dëgjoni çka po thotë zotëriu juaj. Ai vërtet është xheloz, unë jam më xheloz si ai, e All-llahu më shumë se unë.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 450:**

*Transmetohet nga Aishja r.a se ka thënë:*

Erdhi axha i im për nga qumështi dhe kërkoi leje për të hyrë në shtëpi, ndërsa unë e refuzova, deri sa të merrja mendimin e të dërguarit të Allahut s.a.v.s. Kur e pashë Muhamedin a.s., i thashë: O i dërguar i Allahut, axha im për nga qumështi kërkoi leje nga unë për të hyrë në shtëpi, ndërsa unë e kam refuzuar.

Muhamedi a.s. i thotë: Ai ka të drejtë dhe kur të kërkon leje, lejoje.

Unë i thashë: Mua më ka dhënë qumësht gruaja, e jo burri.

E i dërguari i Allahut më tha: Vërtet ai është axha i yt, ka të drejtë.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 451:**

*Transmetohet nga Zadn bin Umeri r.a. se e ka thirrur një rob (djalosh), kur e sheh se ka shenja të rënies (të rrahurit) dhe e pyet:*

*A të është thyer ndonjë pjesë e trupit prej rrahjes.*

*Djaloshi i përgjigjet: Jo!*

*Pastaj Zadani e merr një pjesë dheu prej tokës dhe tha: Unë kam dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

*Kush i mëshon robit, por jo për shkak të thyerjes së ndonjë ligji të All-llahut, kompensimi për të është lirimi i tij.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 452:**

*Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se:*

*Muhamedi a.s. e ka ndaluar Mashtrimin (nexhesh) gjatë shitblerjes.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 453:**

*Transmetohet nga Uthman bin Afani r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

*Mos bëni shitblerje të një dinari me dy dinarë dhe as të një dërhemi me dy dërhem.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 454:**

*Transmetohet nga Hudhejfe r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

*Një njeri ka vdekur dhe ka shkuar në xhenet, e aty është pyetur: Çka keni vepruar?*

*E ai është përgjigjur: Unë kam qenë tregtar, u kam huazuar njerëzve dhe gjithmonë kam pasur tolerancë ndaj atij i cili ka qenë në vështirësi dhe ia kam shtyrë afatin deri në lehtësim, ose deri në tejkalimin e vështirësive dhe i janë falur gabimet.*

*Në atë moment Ebu Mes'udi ka thënë: Edhe unë e kam dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë ashtu.*

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 455:**

Transmetohet nga Talha bin Musrif se e ka pyetur Abdullah bin Ebi Ufije r.a. se a ka lënë vasijet (testament) i Dërguari s.a.v.s dhe është përgjigjur: Jo. Atëherë pse ka lënë porosi për muslimanët të lënë vasijet (testament).

Abdullahu është përgjigjur: Ka lënë vasijet (testament) për librin e All-llahut të Lartmadhëruar.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 456:**

Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se Sead bin Ibade e ka pyetur të Dërguarin s.a.v.s. për nënën e tij, e cila është përбетuar se do ta kryejë një punë, mirëpo ka ndërruar jetë dhe nuk e kryen përбетimin e dhënë. Muhamedi a.s. i ka thënë: Kryeje ti për nënën tënde.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 457:**

*Transmetohet nga Enesi r.a. se:*

Muhamedi a.s. e ka parë një plak, i cili ecte në mes të dy djemve në vështirësi dhe pyeti: Çka ka ky?

Iu përgjigjën se është përбетuar se do të ec vetëm.

Muhamedi a.s. tha: Vërtet All-llahu nuk ka nevojë për ta munduar veten e tij. Ai duhet të hipë në mjet për të udhëtuar.

MUSLIMI |

#### **Hadithi - 458:**

*Transmetohet nga Ukbete bin Amiri r.a. se Muhamedi a.s ka thënë:*

Kompensimi i përбетimit të premtimit është si kompensimi i përбетimit të rrejtshëm për të kaluarën.

MUSLIMI |

**Hadithi - 459:**

*Transmetohet nga Omer bin Hatabi r.a. se Muhamedi a.s ka thënë:*

Vërtetë All-llahu ju ka ndaluar juve që të përbetoheni në emër të baballarëve tuaj. Pastaj ka vazhduar Omeri: Për Zotin, prej atij momenti më kurrë nuk jam përbetuar në dikë tjetër, përpos në All-llahun.

MUSLIMI |

**Hadithi - 460:**

*Transmeton Ebi Hurejre r.a se Muhamedi a.s ka thënë:*

E drejta mbrohet duke u përbetuar.

MUSLIMI |

**Hadithi - 461:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s ka thënë:*

Nuk i prehet dora vjedhësit deri sa të arrihet vlera e një çerek dinarit e më shumë.

MUSLIMI |

**Hadithi - 462:**

*Transmetohet nga Ebi Berdeti el-Ensariju r.a. se e ka dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë:*

Askush nuk mund të dënohet me mbi dhjetë shkopinj, përpos me dënim prej dënimeve të caktuara, të cilat i ka paraparë All-llahu. (Had min Hududil-lahi).

MUSLIMI |

**Hadithi - 463:**

*Transmetohet nga Ajshja r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:*

Vërtet All-llahu i urren më së shumti kacafytësit, ata të cilët vetëm shpijnë në hidhërim.

MUSLIMI |

**Hadithi - 464:**

*Transmetohet nga Zejd bin Halid el-Xhehniyu se Muhamedi a.s. ka thënë:*

A dëshironi t'ju tregoj se cili është dëshmori më i vlefshëm? Është ai, i cili bie dëshmor pa pyetur askënd.

MUSLIMI |